# Shqipëria etnike

| E shtunë 10 gusht 2013 | Viti XIII nr 153 | Çmimi 30 L / 1 euro | E pavarur, periodike | www.shqiperia-etnike.com shqiperia_etnike@yahoo.com | English, page 14 Italiano, pagina 15 | Drejtor Sokol Pepushaj |
|---|---|---|---|---|---|---|




Fati ynë nuk është shkruar për ne, por është shkruar prej nesh!

**OBAMA**



**SFIDA ANTIKORRUPSION E QEVERISË RAMA**
nga Andre Stefani
faqe 4



**RISITË ME QEVERINË E RE**
nga Arben Çokaj
faqe 5



**FUNDI I DEMOKRACISË**
Saranda Pajaziti
faqe 5

# Operohet gabim në Zvicer, spitali përpiqet të falsifikojë dokumentet, tentojnë edhe ta vrasin që të mos flasë

*INTERVISTË E ISMAJL QERIMIT NGA VUSHTRIA E KOSOVËS DHËNË GAZETARIT TONE ARBEN LAGRETA*



## EDITORIAL

### Berisha - rënia e një modeli. Nuk iku, e hoqën!



**nga Lorenc Vangjeli**

Pothuaj pesë vjet më parë, në gusht 2008, Sali Berisha suprizoi me një veprim që zakonisht e bëjnë të dashuruarit. Në majën e malit të Dajtit ai fshehu në shishe një mesazh, që pretendoi se do të hapej vetëm në vitin 2020. Të dashuruarit, premtimet e dashurisë i hedhin në det. Berisha, asokohe dhe gjithë kohën tjetër është dashnor i madh e pasionant i pushtetit dhe mesazhin e tij e mbylli në mal. Pothuaj pesë vjet më pas, të dielën e zgjedhjeve, megjithatë, ai kuptoi se dëshmitarët e tij të 23 viteve, i dhanë divorcin me pushtetin. Tre ditët që pasuan ai heshti dhe të mërkurën, pranoi dhe vetë një gjë të tillë e tha të vetmen fjali që nuk e kishte thënë kurrë në jetën e tij: Po iki! Dhe ktheu krahët përballë një turme pasionante që i përpinte fjalët dhe dëneste. Ndoshta më shumë se për ikjen e pabesueshme të tijën, dëneste për veten. Çdo humbje është në proporcion me pritshmërinë personale: Berisha humbi pushtetin real dhe u duk se dënesi, dikush humbi portofolin e ministrit, mandatin e deputetit, por ata nuk ndodheshin në turmë që t'u dallohej dënesja, shumëkush tjetër kuptoi humbjen e skuadrës për të cilën bënte tifozllëk, pavarësisht se ishte po aq i varfër, po aq i dërmuar sa tifozi i skuadrës tjetër fituese që festonte pikërisht atë për të cilën pala tjetër qante. / f.10

## EDITORIAL

### Qeveria" Rama 1", pa aktorë të komunizmit, pa spiunë me dosje, pa hajdutë; Këto janë "dobësitë" që mund t'i gjejmë para se të nisë punë



**nga Sokol Pepushaj**

Përbërja e qeverisë "Rama 1" është vërtet risi përgjatë tërë histories së shtetit shqiptar, por më shumë se kaq, është një "bombë" që ra mbi "helmetat" e ish diktatorëve, ish spiunëve dhe hajdutëve, është një "çelës" drejt demokracisë, është një start i mire drejt ekonomisë që meritojnë shqiptarët, drejt shtetit të së drejtës dhe penalizimit të SHEIKËVE që kanë ndërtuar kudo, në qëndra qytetesh, ne plazhe, në turizmin malor, që kanë marrë me "5 lekë" jo vetëm pronat publike, repartet ushtarake dhe tunelet e tyre, por edhe pasuritë private dhe kanë ngritur mbi to, nën arrogancen e forcës së pushtetit criminal, dinastitë e të pasurve, duke lënë popullin me bukë me lista?! E shihni si bërtasin hajdutët pa filluar ende punë qeveria me shprehje injorante si: "Peshëngritësi" (Ilir Meta) takon ministrat sipas shijes së "Piktorit" (Edi Rama) dhe anasjedhtas?! / f.3

## Kisha-famulli e Trieshit, dëshmi se shqiptarët aty i përkasin Europës perëndimore

Nga Ndue Bacaj, faqe 13



## Ramazan Spahia, Sali Berisha, Robert Mugabe…

Nga Eduard Zaloshnja, faqe 2



## Shoferi legjendar që shkeli çdo pëllëmbë të tokës shqiptare

Nga Aleksandër Gerxholaj, faqe 12



Shqipëria etnike

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Ramazan Spahia, Sali Berisha, Robert Mugabe…

### *KUR LINDI SALI BERISHA, RAMAZAN SPAHIA ISHTE 7 VJEÇ. DHE JETËT E ATYRE VOGËLUSHËVE MORËN RRUGË KREJT TË KUNDËRTA QYSH NGA AI MOMENT. SEPSE VOGËLUSHI RAMAZAN KISHTE BËRË NJË "FAJ TË PAFALSHËM"*

nga EDUARD ZALOSHNJA

Kishte ardhur në jetë nga një baba që nuk e pranoi ardhjen e komunistëve në pushtet dhe që u vra duke luftuar me armë në dorë kundër tyre. Ndërsa babai i Berishës e përkrahu ardhjen e komunistëve në pushtet dhe, eventualisht, e dërgoi të birin e tij me një valixhe druri në Tiranë, për të filluar ngjitjen meteorike në karierën mjeksore dhe në aktivitetin në rradhët e Partisë së Punës.

Kur Sali Berisha voziste me varkë në Drilon të Pogradecit me të birin e Enver Hoxhës, Ramazani u arrestua në Klosin e Burrelit sepse kishte sharë këtë të fundit. Dhe në 23 muajt që pasuan, ai u torturua çnjerzisht në hetuesinë e Peshkopisë, për të treguar nëse kishte ndonjë bashkëpuntor në "aktivitetin armiqësor" të tij. Pasi hetuesit u bindën për të kundërtën, Ramazanin e dërguan në burgun e Spaçit për të vuajtur dënimin që i dha partia ku Saliu militonte. Në vitin 1992, rrugët e jetës së Saliut dhe Ramazanit u takuan më së fundi. Saliu, pasi ishte larguar nga partia e babait të shokut të tij të vozitjeve në Drilon, kishte dalë në krye të Partisë Demokratike dhe, gjatë fushatës zgjedhore të atij viti, e takoi në Ramazanin në Klos. Që prej atij viti



e deri në 2009-ën, Ramazani votoi rregullisht për Partinë Demokratike, sepse, nga shtrëngimi i dorës që kishte bërë me ish-komunistin Berisha, kishte krijuar një bindje të brendshme se ishte penduar sinqerisht për militimin në partinë që i kishte shkatërruar jetën atij dhe mijra bashkëvuajtësve të tjerë.

Por zvarritjet e pafundme pas zgjedhjeve të 2009-ës, për të marrë këstet e dëmshpërblimit të premtuara nga Saliu para zgjedhjeve, e bindën më së fundi Ramazanin se atij i interesonte vetëm vota e të burgosurve politikë dhe jo dëmshpërblimi dinjitoz i tyre. Dhe kur mori vesh se bashkëvuajtësit e tij ishin futur në grevë urie në Tiranë, Ramazani hipi në një furgon dhe shkoi e u ngujua edhe ai me ta. Dhe vijmë kështu tek dita e djeshme. Dje Saliu festoi me nipër e mbesa datlindjen e tij, ndërsa Ramazanin kishin ardhur ta vizitonin nipërit dhe mbesat, por policia nuk i lejoi të futeshin në çadrën e grevës… Saliu gëzon shëndet të plotë, ndërsa Ramazanin 45-kilësh deshin ta dërgonin që mjekët në spital, por ai refuzoi të dilte nga greva…

Dhe ironia nuk mbaron me kaq. Në ditën kur Ramazani u deklaroi mjekëve se do të vetëflijohej, Saliu u deklaroi deputetëve të tij se do të jetojë edhe kaq vjet sa ka jetuar dhe se do të qeverisë edhe kaq vjet sa ka qeverisur… Dhe kjo deklaratë e Saliut na çon 10 mijë kilometra në jug të Shqipërisë, ku 88-vjeçari i rrjedhur nga trutë Mugabe po garon për t'u rizgjedhur për të n-tën herë president i Zimbabues…

**Shënim**: Në foton shoqëruese, Ramazan Spahia është në cepin e poshtëm, djathtas.

# Kush është Sali Berisha?

nga **Gjin Musa**

Në të kaluarën e herëshme familja e tij është shkëputur nga zonat e Detit Kaspik në Rusi, të cilët kanë emigruar gjatë shekullit të 19-të. Atëherë shumë aradha u larguan nga Rusia duke u dyndur në Evropë, e sidomos në Serbi. Më pas shumica e tyre u zhvendosën në Francë.

Në këtë kuadër nga mbeturinat e mësipërme ngelën edhe në Shqipëri disa familje të rusëve të emigruar, ku një prej tyre është familja Sali Berisha (mbiemri i të cilit është i huazuar dhe i marrë si më i përdorshmi në Kosovë dhe Shqipëri, për shkak se mbiemri i tyre ka qenë sllav më përpara).

Mbas vendosjes në fshatin Viçidol të Tropojës dhe sistemimit fillon edhe veprimtaria e tyre. Të parët e Sali Berishës i kanë vënë dy herë zjarrin Malsisë së Gjakovës, fakt ky që njihet në Tropojë. Që në atë kohë persona të kësaj familje kanë qenë të lidhur me serbët dhe kanë vepruar historikisht kundër interesave të kësaj zone. Sali Berisha në vitin 1962 erdhi në universitetin e Tiranës në degën e mjekësisë. Pasi e mbaroi fakultetin u mbajt në spitalin e Tiranës si mjek zemre dhe më vonë kirurg. Në këtë kohë Sali Berisha filloi të përgatiste dokumentat për t'u futur në parti. Një vëlla i tij mësues me emrin Selim kishte mik kryetarin e Degës së Tropojës, Idriz Shehun. Ky i kërkoi Idrizit ta ndihmonte të vëllain për t'u pranuar në parti. Idrizi i përgjigjet se në kushtet e Sali Berishës për t'u pranuar në parti duhej që edhe ai të ndihmonte shtetin, prandaj duhej takuar ai dhe t'i merrej mendimi, nëse ishte dakort. Pas këtij takimi i vëllai (sot nuk jeton ka vdekur nga zemra dhe ishte i vetmi person pozitiv në fisin e Sali Berishës), pasi mori miratimin e Sali Berishës u kthye në Tropojë.

Të dy u nisën me makinën e Degës së Brendëshme Tropojë për në Tiranë dhe u takuan me persona të Ministrisë së Punëve të Brendëshme, të cilët e tërhoqën në bashkëpunim Sali Berishën me pseudonimin "Penicilina" dhe më pas iu miratua kërkesa për të hyrë në parti. Në atë kohë ishte rregull që dosja e personit që bashkëpunonte me Sigurimin e Shtetit mbahej nga drejtori i Drejtorisë së Punëve të Brendëshme. Kur erdhi në pushtet jo më kot Sali Berisha e futi në burg ish drejtorin Zef Loka, një burrë i ndershëm, i cili e kishte ndihmuar shumë Sali Berishën për çdo problem familjar që ka pasur. Me këtë bazë shpjegohet edhe fakti që i nipi i Idriz Shehut, Baki Shehu, ish gjeneral në kohën e PP-së, drejtues i PS-së, një ditë të bukur bëhet deputet i PD-së.

Gjatë kësaj kohe Sali Berisha u bë një nga personat më të ethshëm për pushtet, duke zbatuar me përpikmëri mësimet e PP-së, deri në zgjedhjen e tij si sekretar partie. Gjatë kësaj kohe filluan t'i shfaqen shënjat e para të sëmundjes psikike, si deliri i madhështisë, hakmarrjes. Për shkak të kësaj sëmundje ai është dërguar edhe në Austri për mjekim nga PP-ja. Sëmundja kurohej nga kolegu i tij psikiatër Ylvi Vehbiu.

Në kohën kur partia merrte nisma për të ndihmuar Veriun shkonin edhe mjekë. Në një mbledhje të zhvilluar në atë kohë, sekretari i partisë së spitalit, Ilir Gjylbegu, ndërmjet të tjerash bëri edhe një kërkesë që Ilvi Vebiu të qëndronte në Tiranë dhe të mos shkonte në veri. Pas kundërshtimit të kësaj kërkese nga antarët kërkuan shkakun. Iliri shpjegoi se ky nuk duhet të shkonte, pasi nuk ka kush të mjekojë Sali Berishën në Tiranë. Kjo thënie doktor Gjylbegut i kushtoi shumë pas 25 vjetësh, kur Sali Berisha u bë kryetar i PD dhe President.

Ky i fundit e hoqi nga profesioni dhe u desh ndërhyrja e disa kolegëve të tij që t'i mbushej mendja Sali Berishës, i cili e lejoi të vazhdonte vetëm pas 3 vjetësh. Gjylbegu ishte specialisti më i mirë në Shqipëri. Ndërsa Ylvi Vebiu me ardhjen e Sali Berishës në pushtet, pa u ndjerë iku në Amerikë, sepse duke e ditur sëmundjen e Sali Berishës do të bëhej kurbani i parë i tij. Para se të ikte në Amerikë u ka thënë disa shokëve të ngushtë "mjerë Shqipëria". Sali Berisha bëri çmos për të gjetur Ylviun.

Gjatë kësaj kohe Sali Berisha martohet me Liri Rexhep Ramën. Rexhepin pas clirimit të vendit, shteti shqiptar bashkë me disa studentë të tjerë i dërguan me studime në Jugosllavi në institutin e fizkulturës. Kur u prishën marrëdhëniet me Jugosllavinë, të gjithë studentët u kthyen në Shqipëri, ndërsa Rexhepi është kthyer pas disa vjetësh, ku ai u martua me Milicën në Kosovë dhe lindën një vajzë, që ja vunë emrin Sllobodanka. Kur erdhën në Shqipëri, ia ndërruan emrin dhe ja vunë Liri.

Në Jugosllavi vjerri i Sali Berishës u tërhoq në bashkëpunim nga UDB. Kjo lidhet me faktin se motra e Milicës, gruas së Rexhepit dhe tezes së Lirisë, ka qenë gjatë luftës oficere e OZNES (pararendëse e UDB) dhe pas clirimit të Jugosllavisë, kolonele e UDB dhe mbështetëse e Rankovicit dhe operacioneve të tij për shfarosjen e shqiptarëve. Ndërsa djali i saj gjatë luftës në Bosnje ishte këshilltar ekonomik i Miloshevicit. Me këtë shpjegohet edhe fakti që krahas detyrave të ngarkuara Sali Berisha ngriti shoqërinë "Shqiponja" për furnizimin me naftë të makinës ushtarake vrasëse të Milloshit.

Mbas këtyre të dhënave, operacioneve të brendëshme të zhvilluara nga Sigurimi i Shtetit, është zbuluar veprimtaria agjenturore e Rexhep dhe Milica Ramës në shërbim të UDB-së, ku dosja e tij është 1200 faqe dhe e gruas 700 faqe dhe ndodhen ne arkivin e SHISH. Kur Sali Berisha erdhi në pushtet nuk mundi t'i zhdukte, por me anë të Gazidedes arriti të pakten të zhdukë dosjen e tij. Edhe Gazidede ishte i rekrutuar nga UDB-ja, i tërhequr në bashkëpunim kur ishte mësues në Peshkopi. Jo më kot Sali Berisha këtij personi i dha një pushtet të pakufishëm para viteve '97, për shkak se ai dinte shumë për të. Bashkë me Gazideden, Sali Berisha ka zhdukur edhe shumë dosje të tjera, të cilat i janë dorëzuar UDB-së.

Fatmirësisht të dhënat e mësipërme për lidhjet familjare të Sali Berishës dhe gruas së tij, nga vitet '97-'98 janë botuar edhe në gazetën kosovare "Koha Ditore".

Të kthehemi në kohën që Sali Berisha ka qenë mjek. Në rrethanat që ndodhej për të arritur piksynimet e tij mësoi se e vetmja rrugë ishte puna këmëngulëse, aktivizimi intensiv në mbështetje të detyrave të ngarkuara nga partia dhe bashkëpunimi me organet e sigurimit. Sa e sa herë Sali Berisha ka përgatitur ambjentet e spitalit dhe ka zbatuar me përpikmëri detyrat e ngarkuara për operacionet e brendëshme që kryente sigurimi i shtetit duke vendosur teknikën operative përgjuese ndaj kosovarëve të arratisur nga Kosova si grupe irredentiste.

Në një rast kur një djalë kosovar që rridhte nga një familje patriotike dhe fisi i tij kishte vuajtur në burgjet e Goli Otokut ishte shtruar në spital, u bënë veprime për të identifikuar personalitetin e tij me anë të Sali Berishës. Ky e identifikoi atë si serb. Kur ky do t'u dorëzohej jugosllavëve në kufi, para se të shkonte në kufirin jugosllav, u hodh nga ura që ishte në terrirtorin shqiptar dhe theu këmbë e brinjë vetëm për të mos rënë në dorë të UDB-së. Kosovari nuk u dorëzua dhe kur u verifikua më vonë doli se ishte vërtet ndryshe dhe u mbajt në Shqipëri.

Nuk janë të paktë mjekët që ka spiunuar Sali Berisha gjoja për veprimtari të dyshimtë dhe armiqësore. Që nga kjo kohë filluan dyshimet ndaj Sali Berishës si agjent i UDB-së jugosllave. Në vitin '91-'92 në Shqipëri u dyndën serb të Kosovës që e flisnin mirë gjuhën shqipe. Ata ishin udhëzuar nga UDB që duke u hequr si kosovarë dhe në bashkëpunimm me agentët e saj në Tiranë të krynin veprime, duke ndikuar në popullin shqiptar kundër kosovarëve dhe në fakt në një farë mase UDB ja arriti qëllimit, me anë të seksit, hapjes së lokaleve, shitjes së mallrave me çmime të shtrenjta, në një kohë kur në Shqipëri kishte varfëri. Në atë kohë Sali Berisha dhe Mehmet Elezi kanë marrë takim me disa prej tyre.

Me këto ngarkesa në biografi Sali Berisha e dinte se nuk mund të ecte duke punuar në mjekësi dhe për këtë hodhi hapin e parë duke rregulluar që stërvitjen ushtarake ta kryente në Brigadën rezerviste të Gardës. Pas këtij hapi, duke shfrytëzuar Dine Abazin, që ishte doktor i Hysni Kapos, arriti ta zevendësonte atë kur mungonte. Kur ishte provizor tek Hysni Kapo, filloi t'i thoshte djalit të tij Besnikut, që ta hiqnin Dinen dhe të merrnin Sali Berishën si doktor të familjes. Këtë bisedë Besniku ia thotë Dines dhe pas kësaj Sali Berishën e vunë në dispozicion të familjes së Simon Stefanit.

Gjatë kësaj kohe Sali Berisha shkonte jashtë shtetit për të bërë analizat e antarëve të Byrosë Politike. Dhe më vonë me specializime nga 6-12 muaj.

Duke ditur dhe lidhjet e mësipërme në këtë kohë UDB-ja filloi përpunimin e tij në Francë dhe më 30 dhjetor 1974 tërhiqet në bashkëpunim nga shërbimi i zbulimit jugosllav me pseudonimin e dosjes "Bisturia" (Pseudonim i cili duhet të jetë ndryshuar). Bisturia është dosja personale e Sali Berishës e ndodhur në arkivat e UDB-së, ku janë të depozituara tërë kontributet e tij në interes të UDB-së.

Më vonë zbulimi shqiptar i dërgon informacion kundërzbulimit se në Shqipëri veprojnë dy kanale të UDB-së. Një kanal kalon nga fshati Viçidol dhe drejtohet nga një mjek kardiolog dhe një kanal tjetër vepron në Shkodër. Ky dokument firmoset nga zvëndësdrejtori i Sigurimit të Shtetit *Sulejman Abazi*. Jo më kot me të marrë pushtetin Sali Berisha urdhëroi menjëherë arrestimin e tij.

Më ardhjen e demokracisë, Sali Berisha filloi të shkruante dhe të botonte disa artikuj për demokracinë dhe shoqërohej shumë me Mehmet Elezin, i cili kishte lidhje të ngushta me Elez Biberajn. Në këto rrethana Perëndimi duhej të zgjidhte një kandidaturë të besuar, që të kishte lidhje të forta që më përpara me vendet perëndimore, të ishte nga Veriu, meqënëse emigracioni më i madh ishte po nga Veriu dhe Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Në këtë kohë perëndimi kishte paraqitur tre kandidatura të cilët ishin Ylli Vejsiu me lidhje familjare në SHBA, Aleksandër Meksi me lidhje në Greqi, ku gjyshi i tij prift ishte kolonel i asfalisë greke dhe Neritan Ceka me mbështetjen gjermane.

Por amerikanët me anë të Rajersonit, i cili ishte komandant i grupeve të emigracionit në Beograd rekomandoi Sali Berishën për kryetar partie të PD, të cilin e mbajtën si të besuarin e tyre dhe e përkrahën më shumë se të gjithë udheheqësit e Ballkanit, por që në fund ky i tradhëtoi.

Sipas informative, UDB-ja përdori të gjitha metodat dhe format, që Sali Berisha të zgjidhej kryetar i PD-së, duke përdorur Rajersonin, për shkak se atëherë CIA financonte Jugosllavinë me fonde për të ushtruar propaganda, për të tërhequr bashkëpunëtorë per vete nga vendet e Ballkanit. UDB-ja ka rekomanduar edhe Sali Berishën.

# Qeveria" Rama 1", pa aktorë të komunizmit, pa spiunë me dosje, pa hajdutë; Këto janë "dobësitë" që mund t'i gjejmë para se të nisë punë

Përbërja e qeverisë "Rama 1" është vërtet risi përgjatë tërë histories së shtetit shqiptar, por më shumë se kaq, është një "bombë" që ra mbi "helmetat" e ish diktatorëve, ish spiunëve dhe hajdutëve, është një "çelës" drejt demokracisë, është një start i mire drejt ekonomisë që meritojnë shqiptarët, drejt shtetit të së drejtës dhe penalizimit të SHEIKËVE që kanë ndërtuar kudo, në qëndra qytetesh, ne plazhe, në turizmin malor, që kanë marrë me "5 lekë" jo vetëm pronat publike, repartet ushtarake dhe tunelet e tyre, por edhe pasuritë private dhe kanë ngritur mbi to, nën arrogancen e forcës së pushtetit criminal, dinastitë e të pasurve, duke lënë popullin me bukë me lista?! E shihni si bërtasin hajdutët pa filluar ende punë qeveria me shprehje injorante si: "Peshëngritësi" (Ilir Meta) takon ministrat sipas shijes së "Piktorit" (Edi Rama) dhe anasjedhtas?! Kërkojnë në vrimë të gjipërës të gjejnë një emër ish komunisti dhe gjejnë ministrin e financave Shkëlqim Cani, gjejnë pra një economist pa dosje si ish Sigurims i Shtetit, pa një post në ish Partinë e Punës, kur deri sot thuajse gjithkund, në çdo pozicion kyç vetëm komunistë, spiunë, hajdutë, mund të gjeje sa të duash. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e përshëndeti kabinetin e ri me vlerësimet që nuk jemi mësuar t'i shohim deri tash. Këta pra janë një ekip i shkolluar në Amerikë, në shumë shtete perëndimore, me përvoja pune atje dhe që kanë qënë 20 vjeçarë e më pak në vitet `90, kur ish komuniostët e kuq u turrën për të mjelur kolltuqet e pushtetit dhe ia arritën për 23 vjet, derisa populli u tha, shporruni. Ndoshta kjo votë kaq kundra, don t'u thotë edhe: "Na i ktheni paratë e pronat e vjedhura, shkoni para drejtësisë se e meritoni, ishit të varfër si ne dhe sot jeni SHEIKË..." Shqiptarë, ju e thatë fjalën si popull që nuk pranon të kapet për hunde, të ripet deri në kockë, prandaj edhe nuk është çudi që pas prezantimit të emrave të kësaj qeverie që nis punën në shtator, të mbeteshin të shokuar gjithë aktorët e vektorët e politikës banditeske me taban nga diktatura komuniste, ata që ishin mësuar ta mjelin karrigen si të ishte lopë, të mbeteshin të shokuar ish Spiunët e Sigurimit të Shtetit, të paaftët, jashtëqitjet që populli me votën e tyre i nxorri jashtë sistemit si jashtëqitjet e kombit, se ka edhe nga këta ndoshta. Në pastë, drejtësia duhet të bjerë mbi ta. Drejtësia, jo hakmarrja. Ky do ishte leximi i votës së sovranit. Partitë, asnjëra, si kjo në pushtet dhe ajo në opozitë, nuk kanë "bekimin" e sovranit të bëhen mbrojtëse të hajdutëve e abuzuesve me paratë publike e taksat e pronat e popullit. "Dita", nëse është e mire, duket në shtator, pasi në aparencë kemi një qeveri me kapacitete intelektuale, me teknicentë e polikbërës model europian, kemi një qeveri me 6 ministre femra dhe asnjë si Majlinda Bregu, kemi një qeveri me moshë të re rreth të dyzetave dhe me asnjë minister si Fatmir Mediu, (FISHEKU) a Arben Imami, (GËRDECI.)

Fenomeni më negativ që pengoi prej 23 vitesh






shtetformimin ligjor, ishte pikërisht boshti politik që u materializua si diktaturë kundër popullit, varfëria ekstreme e shoqërise, autoritarizmi i pushtetit, abuzimi me paratë e taksapaguesve dhe krijimi i sheikëve, të tërë në pushtet ose afër tij. Ky model qeverisës i keq, i urryer deri në neveri, prodhoi një rezultat ndëshkues më shumë se fitues në zgjedhjet e 23 qershorit, një rezultat që përveç votueit nuk mundi ta parashihte askush. Të pasurit nuk ua dinin të varfërve dhe të varfërit nuk e dinin se janë aq shumë. Tri ishin partite që pritnin tepër më shumë se morën, PD-ja e Berishës, Aleanca e Topit dhe Fryma e Spahiut. Te tria këto forca politike bënë një fushatë jashtë modelit civilizues, të egër, nacionaliste, të fryrë, duke u paraqitur edhe kësaj here si "shpëtim" nëpër mitingje e tribuna, megjithëse vinin nga një "thes". Sali Berisha, burri që drejtoi më shumë shtetin pas Enver Hoxhës në tërë historinë 101 vjeçare te shtetit shqiptar, duke u kujtuar shqiptarëve vetëm suksese e duke harruar ose mospranuar asnjë humbje, shkoi nga vota mbarëpopullore në humbjen më të thellë që njeh historia në tërë botën demokratike. Unë nuk di një rast tjetër, ku ndëshkimi është kaq i fortë. Kreshnik Spahiu, njëri ndër supërpërgjegjësit e lëkundjeve të sistemit të drejtësisë, pasi qëndroi e drejtoi Këshillin e Lartë të Drejtësisë për shumë vite, sipas devizës së ish Presidentit Topi, i cili tashmë, pasi drejtoi shtetin për pesë vjet si përfaqësues i "Unitetit të Popullit", besonin në devizën komuniste, njëlloj si PD-ja, se votuesi gënjehet, se votuesi tashmë është si sklavi që e respekton shfrytëzuesin e vet, pa e mënduar as në ëndrrat faktin se populli, nga Vermoshi në Konispol, i etiketon si gjynahtarë, si fajtorë të gjëndjes aktuale të jetës shoqërorë, politike e ekonomike të vëndit.

Deri sot Shqipëria ka patur qeveri me orientime nacionaliste, me ide tashmë të vjetëruara për Europën, të lindura, rritura, pikërisht nga politika që ato kritikonin me fjalë dhe që mbartnin pikërisht mashtrimin për shtresën e mesme dhe të varfër të shoqërisë, për ata që mëndonin se edhe mund t'i mashtrojnë më lehtë. Në Botën e sotme demokratike, është jashtë logjike të kërkosh "besim të ri" në terren të vjetëruar, të coptosh tortën tënde plot korrupsion e të ndash si për sevap ndonjë thërrime në fushatë, ta shesësh veten të ndershëm kur je përgjegjës i gjithë të këqijave, të ulesh ne shtrat si Djall e të ngrihesh në mëngjes si Engjëll dhe anasjelltas, duke u përpjekur të gjesh "një qime derri" në një ton lesh, duke u përpëlitur të fyesh qeverinë e re" Rama 1" para se të filloi punë. Qeveria do kritikohet, bile rëndë, tepër më rëndë se ajo që iku e ia harroshim bëmat, pikëtisht nga autori i këtyre rreshtave, nëse funksionon drejtësia si deri sot, nëse ekonomia do jetë me panolina nëpër këmbë si deri sot, nëse pushtetarët e rinj do ngrejnë hotele e motele nëpër plazhe si deri sot, nëse korrupsioni nuk do dënohet se më të forte se Silvio Berluskoni nuk i kemi këta tanët, nëse nxënësit e shkollave do shihen të detyruar nëpër mitingje të mazhorancës si deri sot, nëse injorantët që kanë blerë diploma do i shohim si drejtues institucionesh si deri sot, nëse ilaçet nëpër spitale do blihen me para nga të sëmurët deri sot, nëse pronat nuk u merren hajdutëve u t'u rikthehen të zotëve, pronarëve, nëse…

Qeverisjet hajdute dhe ekstremiste me produkt konflikte e diferencime shoqërore, nuk mund të zgjojnë ndjenja popullore, revolucionare proletare, as kombinim orientimi oriental në një shoqëri demokratike, ku klasa e mesme tashmë është bazë e strukturës europiane për ku jo vetëm është qasja jonë, por kemi trokitur pas derës së Europës. Kjo është deviza që duhet të marrë përsipër Qeveria "Rama 1", për të qeverisur krejtësisht ndryshe, pse jo edhe për të hapur dosjet e korrupsionit, të diktaturës dhe të tjetërsimit galopant të pronave.. Në këtë prag zgjimi, të diktuar nga vota mbarëpopullore prej Vermoshit në Konispol, mjeranët që populli i nxorri si jashtëqitje me votë, duhen lënë në madhështinë e humbjes së madhe, të ndëshkimit të madh. Ekipi i ri qeverisës, ka përgjegjësinë e shpresës së madhe europiane, duke mos krijuar turbulanca mbi turbullira, por duke sekuestruar pronat e SHEIKËVE të politikës e pushtetit që hynë në politike e ulën prapanicat në karrige me portofole bosh, e sot janë bërë pronarë të gjysmës së Shqipërisë. Kujtoj një deklaratë të asaj që i pëlqente kur e përkufizonin si Zonja e Hekurt, të ish kryeparlamentares Topalli në parlament: " Nuk jam çorapegrisur si ju socialistët, jam pronarja e gjysmës Shkodrës" Më thoni, është kështu apo jo? Po pronatët e tjerë në Shkodër ku janë, o popull, se kishte Biçisten, Kafe të Madhe, punishte që prodhonin e bënin tregti me Venedikun, me Europën, kishte shtypshkronja e anije kryeqëndra e veriut dhe këta nuk kanë "GJYSMËN E SHKODRËS" sot dhe normale është se populli nuk janë as 100 as 200 shtëpi… Po. janë me qindra këta ish pronarë që sistemi dictatorial ua pat sekuestruar pasuritë, por paradoksi është këmbëkryq në faktin se si Jozefina paska gjysmën e pasurisë së Shkodrës, se ajo duhet të ketë patur parasysh në deklaratën publike edhe pasuritë publike dhe të gjithë popullit të Shkodrës, kur ka deklaruar kështu e Berisha ka qesh, ka qesh fort se Jozi u dha një grusht të forte njerëzve që janë "ÇORAPËGRISUR". Por jo vetëm në Shkodër kështu, kudo nëpër qytete po të pyesësh, kudo nëpër plazhe po të pyesësh, kudo nëpër qendra turistike po të pyesësh, të tregojnë pasuritë e tyre marramëndëse, prandaj edhe vota i ndëshkoi. I ndëshkoi për t'ua sekuestruar pasuritë, siç ka ngjarë edhe në vënde të tjera. Dhe, të mos harrohet, ky popull voton prapë pas katër vitesh, nëse pasuria e grabitur nuk i rikthehet e gjuan prapë me "GRUSHT të fortë , malin që s'bzan".

**Sokol Pepushaj**

# Një reportazh i shkurtër nga trevat shqiptare, ku kanuni mesjetar sfidon ligjet bashkëkohore

Në Boten e qytetruar duket disi e pabesueshme se si në një vend Europian si Shqiperia sot në shekullin e 21-të ka më forcë kanuni mesjetar i Lekë Dukagjinit ,se ligjet bashkohore civilizuese që kanë ndertuar e zhvilluar Boten demokratike dhe Bashkimin Europian, pjesë e të ciles pretendojme të jemi edhe ne shqiptaret. Rastet ku kanuni bënë kërdinë me kodet e tij të gjakmarrjes janë të shumta dhe ne si gazetë e pavarur ("Shqiperia Etnike"), shpesh i kemi publikuar me qellim sensibilizimin e organeve shtetrore dhe vet opinionit ,per të luftuar ketë fenomen që çdo ditë derdhë gjak shqiptaresh kotë. Në vijim të punes sonë sensibilizuese kesaj radhe kemi zgjedhur të publikojme rastin e zotit Arben Gjon Buraj nga komuna Kastrat (Malesi e Madhe) ,i cili prej kohesh është detyruar të largohet familjarisht nga Shqiperia ,(madje sipas të dhenave që na dhanë bashkefshataret e tij ), kjo familje është shperndarë "si zogjtë e korbit" neper Europë per të shpetuar nga një gjakmarrje e mundëshme që ju a kerkojnë djemt e të ndjerit Fran Vuksanit , i vrarë me armë zjarri me 28 korrik 2012 në një rrugicë të qytetit të Shkodres...Ne si gazetë duke pasur edhe qellim investigues mesuam se kjo ngarje tragjike e kishte "burimin" te pa-aftesia e shtetit shqiptarë per të zgjidhur drejtesisht problemin e pronave ,të trashiguara ,por edhe të ngatërruara gjatë viteve të sistemit komunist. Acarimi i konflikti të pronsisë në mes familjes "Buraj" dhe familjes "Vuksani" ka si datë 29 qershorin 2012 ,kur Arben dhe Sokol Buraj-t ,ju është prishur gardhi i shtepisë së tyre dhe per ketë kanë njoftuar policinë ,duke akuzuar si autor Fran Vuksanin me djemt e tij ,pasi kishin pasur konflikt pronsie ,prej kohesh. Megjithse situata per momentin u duk se u qetsua disi , Fran Vuksani duket se e kishte ndier vehten të fyer ndaj në fshehtesi kishte organizuar (me djemt e tij) rrahjen barbare të Arben Buraj-t me daten 12 korrik 2012 . Arbeni pas kesaj rrahje (dhunimi fizik) është detyruar të shtrohet në spitalin rajonal Shkoder. Pas ketij momenti fatkeq konflikti ne mes familjeve Buraj dhe Vuksani ishte acaruar maksimalisht. "Vulen" ketij konflikti që do të merrte rrugen e gjakmarrjes ja vendosë perfundimisht vrasja me armë zjarri e Fran Vuksanit me daten 28 korrik 2012 në një rrugicë të Shkodres nga persona të pa identifikuar per momentitin. Djemt e Fran Vuksani-t pas kryerjes së riteve zakonore të varrimit dhe prtijeve per ngushëllim , me daten 13 gusht 2012 shpallen gjakmarrjen kundrejt familjes "Buraj", pasi sipas tyre mashkujt e kesaj familje kishin vrarë babain e tyre Fran Vuksanin. Pas kesaj shpallje hyri në veprim kanuni mesjetar i Lekë Dukagjinit...Gjaku i Fran Vuksanmit lahej vetem me gjak ,pra duke vrarë Arben Buraj-n , Sokol Burajn ,apo ndonjë mashkull tjeter të kesaj familje. Mashkujt e familjes "Buraj" nuk pranonin se e kishin vrarë ata, Fran Vuksanin ,madje as organet e specializuara të hetimin nuk kishin arritur të zbulonin vrasesin e vertet.. Gjithsesi per hirë të vertetes duhet thënë se menjehere u aktivizuan institucione e organizma lokal e shtetrore ,me qellim ndalimin e gjakmarrjes dhe rregullimin në mes ketyre dy familjeve. Nga institucionet apo organet lokale e shtetrore nderhynë ; Komuna , Kryepleqësia , Policia ,ndersa nga institucionet shoqerore nderhyri Shoqata Misionaret e Paqes dhe Pajtimtaret..Por mjerisht djemt e Fran Vuksanit nuk pranuan të pajtohen me familjen "Buraj" . E gjithë familja "Buraj" u detyrua të ngujohet ,pasi perndryshe ata do të vriteshin per gjakmarrje, ku më i kerkuara per tu vrarë është Arben Buraj me djalin e tij. Prandaj në keto kushte, Arben Buraj familjarisht ishte detyruar të largohej nga Shqiperia...

O tempora o mores, Kanuni mesjetar sfidon ligjet bashkohore të shtetit e shoqerisë shqiptare... Deri kur keshtu...

**Ndue Bacaj**

# Atentat mafioz në Shirokë

Atentatet dhe vrasjet mafioze nga dita në ditë po rriten. Bandat e krimit ndihen të sigurta në bërjen e vetëgjyqësisë, pa iu trembur ligjit dhe burgut. Madje, krimi është edhe mbi shtetin, kriminelët vrasin njerëz të pafajshëm dhe drejtësia jo vetëm që nuk i dënon, por as i zbardh ngjkarjet. Kështu ka ndodhur edhe me rastin në fjalë. Një atentat mafioz i ndodhur më 22 korrik, rreth ores 21 oo në vëndin e quajtur Varrezat e Shirokës, një fshat turistik rreth tetë kilometer larg qytetit të Shkodrës, megjithëse është kalëxuar ne Prokurorinë e Krimeve të Rënda për hetim, ende nuk është zbardhur. Viktimë e këtij atentati ka qënë riu 25 vjeçar nga fshati Berdicë, Edmond Gjergji. Gjergji kishte shkuar për të peshkuar në fshatin Zogaj dhe teksa kthehej me makinën e tij tip Mercedes-benz 190 kubikëshe për në shtëpinë e tij, rrëth ores 21.oo te dates 22 korrik, një makinë nga pas i ndez dhe i fikë dritat e gjkata që ai të ndalojë. Edmond Gjergji ul shpejtësinë dhe makina e parakalon dhe i zë rrugën. Nga makina, sa hap e mbyll sytë, kanë dale plumba pistolete në drejtim të tij. Mbi xhamin e pare të makinës është hapur zjarrë dhe i riu është shtrirë poshtë sedilies. Makina që ka hapur zjarrë, si duket ka mënduar se e ka vrarë të riun Edmond Gjergji dhe është larguar në punën e vet. Policia e Qarkut Shkodër ka sekuestruar makinën e viktimës dhe çështja i ka kaluar Prokurorisë së Krimeve të Rënda për hetim. Kanë kaluar shumë ditë dhe Edmond Gjergji jo vetëm nuk është lajmëruar për zbardhjen e atentatit, por edhe është detyruar të jetoi i fshehur, pasi kriminelët mund ta vrasin. Rrezikimi serioz i jetës së këtij të riu, jo



vetëm nuk shqetëson prokurorinë, por sipas dëshmisë së një oficeri të Policisë Kriminale të Qarkut Shkodër për gazetën, i cili na siguroi të dhënat dhe fotografinë e viktimës Gjergji, edhe ai vetë do ishte i rrezikuar me jetë po të identifikohej. Pra, oficeri i Policies Kriminale jep informacion për gazetën, por ka frikë edhe për jetën e vet.

Është ky një rast tragjik, si shumë raste të tjera ku dosjet e krimit komandojnë zyrat drejtësisë.

**Redaksia**

Shqipëria Etnike

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Sfida antikorrupsion e qeverisë Rama

Në bilancin e qeverisë Berisha në largim, një nga treguesit më të këqij është korrupsioni sa galopant, aq edhe epidemik. Krejtësisht në kundërshtim me premtimet e dhëna në vitin 2005, se do qeveriste me duar të pastra dhe me tolerancë "0" në luftën kundër korrupsionit, Berisha rikthehet në opozitë, duke lënë pas një shtet edhe më të korruptuar se ç'e mori nga Fatos Nano. Shqipëria është zhytur edhe më poshtë në klasifikimet ndërkombëtare, duke iu afruar grupshteteve më të korruptuara në botë. Në fakt, vota thuajse plebishitare kundër qeverisë Berisha është tregues edhe i indinjatës në rritje të shqiptarëve kundër korrupsionit. Prandaj edhe mandati që ata i kanë dhënë Edi Ramës, socialistëve dhe aleatëve të tyre, është njëherazi edhe një kërkesë për luftë urgjente kundër korrupsionit. A do të mund ta përballojë qeveria e re këtë sfidë, duke përmbushur besimin publik?

Ka 23 vjet që të gjitha qeveritë shqiptare dështojnë, njëra pas tjetrës, në luftën kundër korrupsionit. Dhe i pandëshkuar, korrupsioni i ka shkaktuar plagë shumë të rënda projektit të shtetit ligjor në Shqipëri. Përveç pengimit të zhvillimit ekonomik apo rrënimit të mjedisit, korrupsioni ka sjellë një diferencim të frikshëm pasuror, nga njëra anë një rritje të varfërisë për shumicën e popullatës dhe, nga ana tjetër grumbullim për një kohë të shkurtër të pasurive përrallore në një grup relativisht të vogël njerëzish. Dhe pikërisht ky grup përbën sot atë "klasë", që jo vetëm nuk e dëshiron, por do të përpiqet për ta penguar luftën kundër korrupsionit. Ai jo vetëm ka shumë para (pra pushtet), por ka ndikim në tërë spektrin politik, sepse ka përfaqësuesit e vet në të gjithë partitë politike. Gjatë këtyre 23 vjetëve korrupsioni ka infiltruar në politikë, duke u bërë pjesë integrale e klasës politike. Nuk është rastësi që jo pak politikanë numërohen sot ndër më të pasurit e vendit, ndërsa jo pak të tjerë bëjnë një jetë me shumë parametra luksozë.

Në objektivin e saj antikorrupsion, qeveria e re duhet të përballë kundërshtinë e këtij grupi njerëzish që ndodhen edhe brenda





kampit të saj. Është pikërisht ky një nga faktorët që rrezikon ta tresë vullnetin e saj për një qeverisje ndryshe nga ajo e korruptuara në largim. Por kjo sfidë është e kapërcyeshme nëse në kokën e qeverisë ekziston një vullnet i palëkundur për të luftuar korrupsionin. Ndërkaq sfidën më të madhe e paraqet mungesa e një pushteti të pavarur dhe realisht të depolitizuar drejtësie. Jo vetëm prirjet autokratike të kryeministrave si Berisha apo edhe ato të Nanos (ndonëse disi më të moderuara), por edhe nevoja për të krijuar një qiell pandëshkueshmërie për qeveritarë të korruptuara, nuk kanë lejuar të lindë dhe të konsolidohet një hetuesi dhe gjyqësi realisht e pavarur. Ndërkaq, edhe vetë brenda pushtetit të drejtësisë, korrupsioni bën kërdinë. Dhe është utopike të shpresosh se një qeveri, kushdo qoftë ajo, mund të çojë përpara luftën kundër korrupsionit, duke i dhënë fund pandëshkueshmërisë proverbiale për qeveritarë të korruptuar, bazuar mbi një prokurori të varur në lloj-lloj çengelash politikë dhe një gjyqësor të mbushur me gjyqtarë që mbrojnë qeveritarë e politikanë të korruptuar, por edhe janë mbrojtur prej tyre kur rrezikoheshin nga drejtësia.

Mungesa e një pushteti drejtësie të pavarur ka dy të këqija të mëdha: I mungon vullneti, dedikimi për luftë pa kompromis kundër korrupsionit dhe mund të akuzohet shumë lehtë nga të korruptuarit e politikës se po përdoret nga kundërshtarët e tyre për revansh politik. Në Itali nuk akuzon kush qeverinë apo kundërshtarët politikë të Berluskonit për revansh kur gjykata dënon Kavalierin me 7 vjet burg. Po kështu, edhe kur kryeministri dënohet nga drejtësia në Kroaci. Pse? Sepse atje është krijuar pushteti i drejtësisë që gëzon reputacionin e të qenurit i pavarur nga politika. Ndërsa në Shqipëri është e sigurt si 1+1=2 se, nëse ndonjë gjykatës do të tentojnë të ndëshkojë sipas ligjit, ndonjë ish-ministër të korruptuar të qeverisë Berisha, do të jetë ky i fundit që do të ulërasë, (këtë herë me gojën e Bashës) për revansh politik, gjueti shtrigash apo persekutim të opozitës politike. Kjo formulë i ka ecur për bukuri Berishës gjatë 8 viteve në opozitë pas vitit 1997. Korrupsioni i qeverisjes së tij të parë jo vetëm nuk u ndëshkua, por ishin edhe vetë ndërkombëtarët që ndërhynë pranë qeverive socialiste të asaj kohe (dhe këto të fundit pranë Prokurorisë), duke sugjeruar të mos ndëshkohet Berisha, sepse mund të destabilizohet vendi.

S'ka asnjë dyshim se Berisha do të ndjekë përsëri këtë taktikë për të penguar ndëshkimin e korrupsionit të njerëzve të tij. Por jemi në një moment kur gjerat nuk mund të vazhdojnë më kështu. Lufta kundër korrupsionit është jetike për jetëgjatësimin e demokracisë dhe projektin e shtetit ligjor në Shqipëri, për integrimin real të saj në Europë. Pa një përpjekje të tillë, integrimi është një fjalë boshe. Jo rastësisht, edhe ndërkombëtarët po këmbëngulin në nevojën e rekordeve konkrete në luftën kundër korrupsionit. Dhe nuk është fjala për të ndëshkuar a për të demaskuar ca infermierë apo mësues që marrin ryshfet. Është fjala për peshkaqenët e korrupsionit, kryeministra, ministra, zëvendësministra, për ata që bëjnë korrupsionin e madh, që gëlltisin "me ligj" dhe proceduralizëm antidemokratik miliarda nga paratë e taksapaguesve të varfër shqiptarë. Është fjala që ligji të ndëshkojë jo vetëm "Zhan Val'zhanët" e rrugës, por edhe "Sanaderët" e qeverive. Në emër të barazisë para ligjit, duke i dhënë fund kulturës së pandëshkueshmërisë. Gjë që nuk mund të bëhet në gjendjen ekzistuese të prokurorisë dhe të gjykatave. Kërkohet një reformë e thellë dhe e shpejtë. Dhe në rast se kjo është e pamundur të kryhet në një kohë të shkurtër, duhen kërkuar rrugë të tjera. Lufta kundër korrupsionit nuk pret. Duhen huazuar nga përvoja botërore praktika të suksesshme të krijimit të agjencive të posaçme për luftën kundër korrupsionit. Në bashkëpunim me struktura të shoqërisë civile që ekzistonin dikur në Shqipëri (si Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit), por që u rrafshuan kur në vitin 2005 erdhi në pushtet Sali Berisha. Ato duhet të ringrihen në bashkëpunim me ndërkombëtarët dhe po në bashkëpunim me ta, mund të kërkohet krijimi i një mekanizmi antikorrupsion (në shtete të ndryshme janë krijuar dhe gjykata të posaçme antikorrupsion), qartazi i depolitizuar. Vetëm kështu të korruptuarit e politikës nuk do të mund të mbrojnë mëkatet, duke u qarë për "revansh politik".

**Andrea Stefani**

# Ngatërresa për makinën lind një konflikt të forte

Është Kryetari Misionit të Paqes dhe Pajtimit Shqiptar Mustafë Daija, i cili deklaron për gazetën tonë një rast konflikti, të cilin misionari i paqes nuk ka mundur ta sheshoi deri tani, megjithese ka bërë shumë perpjekje mes familjes Sallbia e Kraja. Sipas misionari Daija, Kujtim Kraja është kërcënuar me jetë mbrëmjen e 17 shkurtit 2012 nga N. Sallbia në lagjen 'Ahmet Haxhija' në Shkoder.

Kujtim Kraja punonte si motorist në banesën e vet dhe disa ditë më parë kish riparuar motorin e makinës së shtetasit N. Sallbia. Këtij të fundit i ish djegur motori i makinës dhe pikërisht mbrëmjen e 17 shkurtit 2012 kish shkuar dhe i kish kerkuar me forcë paratë e motorit, motoristit Kraja. Motoristi i kish thënë se defekti nuk është për faj të tij, por se klienti e ka lënë makinën të nxehet, pra ose pa vaj ose pa ujë. Sallbia nuk është bindur dhe në debat e sipër ka nxjerrë pistoletën për të qëlluar mbi shtetasin Kujtim Kraja. Kraja në moment ka arritur ta çarmatos dhe po me ate armë të plagose ne këmbë të zotin e armës, të quajturin N. Sallbia. I plagosuri i ka thene motoristit Kujtim Kraja se do e paguante me nje jete njeriu kete veprim dhe menjëhere ka hypur ne makinen e tij sebashku me nje shokun qe e shoqeronte dhe jane larguar nga vendngjarja. Qe atë nate familja Kraja mbyll sherbimin e riparimit te makinave per te mbrojtur jeten. Por pak ditë me vone është pikerisht djali i motoristit, i quajturi Arben Kraja që është bëre viktime e nje dhune fizike ne mes te qytetit, afer teatrit "Migjeni" nga disa persona te panjohur, te cilet e kane paralajmeruar se heren tjeter do e vrasin. Duket se kane qene te futur nga personi me te cilin i ati i viktimes Arben Kraja, kishte patur konflikt per makinen. Krymisionari i pajtimit te konflikteve Mustafë Daija deklaron se Arben Kraja tashme ndodhet i fshehur dhe familja Kraja e rrezikuar si shkak edhe i mungeses së forces se shtetit, tek i cili viktimat jo vetem nuk gjejne zgjidhje, por edhe ne rastet kur denoncojne, eshte e madhe frika e nxjerrjes se sekreteve pikerisht nga struktura te policise.

**Redaksia**

# Tragjedi shqiptare në Itali



Frrok Kola, i martuar, baba i katër fëmijëve, tre djemve dhe një vajze, kohët e fundit ndihet i rrezikuar me jetë. Është pikërisht një i burgosur në Itali për vrasje, që tashmë në fund të vuajtjes së dënimit, i ka çuar fjalë se sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, pasi Frrok Kola ka qënë jo vetëm dëshmitar në ngjarje, por edhe dëshmitar në karabinieri dhe ku ai ka marrë dënimin e gjatë, i ka borxh, dhe kjo paguhet me jetë. Në fakt, në shqipërinë postkomuniste, vetëm 20 vitet e fundit, sipas një studimimi botuar në gazetën Corriere della Sera nga gazetari Ettore Moo, janë pushkatuar rreth 20 000 persona për shkak të ngatërresave e hakmarrjeve nga më primitivet. Po cila është ngjarja që kërcënon seriozisht familjen Kola?

Më 3 prill 2003, një ndeshje futbolli mes emigrantësh shqiptarë në Itali, është bërë shkak që Petrit Kola të ngatërrohet me bashkëatdhetarin, madje edhe nga e njëjta komunë në Shqipëri, nga Bushati, Agron Frroku. Dy nga vëllezërit Kola, Petrit dhe Pjerin kanë komunikuar në telefon me Agron Frrokun dhe e kanë acaruar konfliktin me fjalë fyese, madje edhe duke lënë takim të përleshen me armë. Frrok Kola që është personazh kryesor i këtij shkrimi, pasi është i pafajshëm, pasi ka ndihmuar edhe në zbardhjen e ngjarjes së rëndë me dëshmitë e sakta në karabinierinë italiane dhe çuditërisht sot edhe i kërcënuar seriozisht me jetë, duke qënë kushëri i Agron Frrokut, pasi ishte dëshmitar okular edhe i ngatërresës në futboll dhe shok e mik edhe i Petrit Kolës, ka marrë përsipër të sheshojë ngatërresën.





Ka marrë makinën dhe ka shkuar e takuar vëllezërit Mark, Bardhok dhe Petrit Kola, ku u ka thënë se një ngatërresë e vogël duhet të mbyllet se jemi miq nga i njëjti shtet dhe i njëjti fshat në Shqipëri. Në shtëpi të Bardhok Kolës, Frrok Kola duket se gjen gjuhën e pajtimit, duke i ulur të bisedojnë të dy palët në konflikt. Kështu caktohet një takim në shtëpinë e Gjergj Frrokut në Camposampiero. Në këtë takim pajtimi nuk arrihet, madje acarohet. Kushëriri i Frrok Kolës, i quajturi Gjergj Frroku, merr në makinë e tij palën kundërshtare, vëllezërit Mark Kola dhe Pjerin Kola dhe niset për tek shtëpia e Bardhok Kolës, gjithnjë me shpresë pajtimi. Ndërsa Frrok Kola, meqë kishte edhe rrugën andej nga shtëpia e Bardhok Kolës merr në makinë vëllezërit e Gjergj Frrokut, Agronin dhe Artanin dhe ndjek nga pas makinën e Gjergjit. Shkojnë atje ku ishin nisur. Gjergj Frroku së bashku me Mark dhe Pjerin Kolën futen në oborrin e shtëpisë së Bardhok Kolës, ndërkohë Frrok Kola me Artanin dhe Agronin presin jashtë oborrit në makinë, sa të vijë Gjergj Frroku. Gjatë kësaj kohe ku dukej se Gjergj Frroku po i jepte fund konfliktit, njëri nga vëllezërit Kola, pikërisht Pjerin Kola, në befasi, sa hapë e mbyll sytë, ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar mbi vëllezërit Artan dhe Agron Frroku. Agron Frroku ka mbetur i vdekur në vënd nga një plumb në gjoks, ndërsa vëllai i tij Artan Frroku ka marrë një plumb në kokë, por ndërhyrja e mjekëve ka bërë që jeta e tij të vazhdojë. Karabinieria italiane ka shkuar për rreth 10 minuta në vëndngjarje. Kjo tragjedi shqiptare në Itali ka ndodhur me datën 5 prill 2003, në orën 21 e 35 minuta në Massanzago. Autori i vrasjes është larguar dhe pak pas mesnate është arrestuar. Frrok Kola, deshmitar okular i ngjarjes, pasi ka çuar në spital kushërin e plagosur Artan Frroku, ka bashkëpunuar me karabinierinë italiane dhe ka dhënë dëshmi të plota e të sakta. Vrasësi Pjerin Kola është dënuar me 13 vjet burg nga drejtësia italiane. Por kjo dëshmi duket se i ka kushtuar shumë shtrenjt shtetasit dhe familjarit të mirë Frrok Kola. Tashmë që po afron lirimi i vrasësit Pjerin Kola, Frrokut i kanë ardhur shumë kërcënime se ai sapo të lirohet do e vrasë. Ngjarje të tilla në fakt ndodhin shumë shpesh mes shqiptarëve. Normat e vjetra kanunore nuk duan t'ia dinë për asgjë, duke e bërë hakmarrjen në fenomenin që po merr përditë e përnatë jetë të pafajshme njerëzish

**Redaksia**

# Risitë me qeverinë e re

Arben Çokaj

Pas një fushate relativisht të mirë dhe të qetë, koalicioni i majtë për Shqipërinë evropiane fitoi bindshëm. Shkodra e konsideruar si bastion i PD-së, më shumë se kishte një grup kriminal, që gjithmonë e deformonte votën në Shkodër, sesa shkodranët votonin PD-në, e përmbysi gjithashtu rezultatin. Shkodra iu bind kështu orientimit Evropian të vendit, si pjesa tjetër e Shqipërisë, ku u votua ndjeshëm koalicioni i PS-së. Shkodra pra, nuk u nda nga pjesa tjetër e Shqipërisë në trendin e votimit dhe kjo ishte një shenjë e civilizimit të elektoratit shkodran.

Edi Rama kishte mbajtur një fushatë dinjitoze me premtime të besueshme dhe shkodranët, si pjesa tjetër e elektoratit të civilizuar në Shqipëri, treguan se vota ka kuptim dhe nuk shkojnë me krye në thes si militantët, për të votuar një parti të caktuar, në të mirë e në të keq, por votojnë sipas interesit më të mirë për vendin. Shkodranët zgjodhën kësaj here alternativën e majtë, pa dashur të injorojmë me këtë rast edhe mekanizmat që përdoren gjithmonë në fushatë për mbledhjen ose blerjen e votës, mekanizma të cilat nuk ka dyshim që ushtrohen fatkeqësisht nga të dyja palët, gjë që duhet të vijnë duke u ndalur përfundimisht.

Por ashtu, siç e bëri fushatën Rama, ashtu edhe fitoi, me një fitore të thellë, që habiti edhe më optimistët dhe i kaloi në një shock emocional edhe Partinë Demokratike, e cila e parandiente një humbje të mundshme, por jo kaq të thellë. Hapja e kutive në Lezhë tregoi se kishte patur disa manipulime në procesin zgjedhor, edhe Shkodra gjithashtu. Por në Shkodër rezultati nuk u ndryshua as me hapjen e kutive, gjë që tregoi se procesi zgjedhor në Shkodër ka qenë relativish i rregullt, për kushtet e Shqipërisë.

Qeveria në ikje Berisha, mund të shënojë një rekord në këto 23 vjet, për shkallën e lartë të korrupsionit, të krimit të organizuar, të vrasjeve, të papërgjegjshmërisë së organeve shtetërore, të futjes së elementeve kriminale në struktura drejtuese të policisë dhe të shtetit, të tjetërsimit të realitetit, të gënjeshtrave dhe premtive të pambajtura, etj. Qeveria Berisha ua solli shqiptarëve në majë hudës me borxhin e madh publik, ndërtimet pa leje, varfërinë ekstreme si dhe çmimet e larta në treg. Ndaj dhe u ndëshkua me votën e lirë.

Ndërsa që në fillim, qeveria Rama e sapo-krijuar këto ditë, shënoi mjaft risi. E para, nuk ka elementë në qeveri të përfolur për afera korruptive, apo si fuksa të sigurimit të shtetit. Ka një numër të konsiderueshëm femrash ministre, shumica e të cilave janë femra me një nivel të lartë intelektual dhe të sprovuara në punë drejtuese, që kanë dhënë rezultate në punë. Qeveria ruan më mirë se kurrë edhe një ekuilibër fetar brenda saj, përveç se ka edhe një ekuilibër në mes gjinive, si asnjë qeveri tjetër para saj. Nëse qeveria Berisha kishte vetëm një femër shashkë, ministren e integrimit Majlinda Bregu, një gënjeshtare e falsitetit të lartë, 6 ministret e qeverisë Rama, nuk përmenden për mungesë korrektese, janë femra serioze, që shpresoj ta nderojnë edhe qeverisjen e vendit.



Qeveria e re tregon se Edi Rama e ka marrë shtetin seriozisht, ashtu siç edhe pati premtuar gjatë fushatës. Jo vetëm qeveria me risitë e moshën e saj relativisht të re të ministrave, por edhe krijimi i insitucioneve të tjera të vendit, si Byroja kombëtare e anti-krimit, etj. do i shërbejnë vendit tonë, për t'u paraqitur seriozë para elektoratit shqiptar dhe para ndërkombëtarëve. Do na ndihmojë ne si vend për të qenë normalë në mesin e vendeve të zhvilluara evropiane. Se në Evropë shkohet vetëm duke rritur standardet e qeverisjes dhe të jetës në vend, standarde që i duhen popullsisë sonë në radhë të parë, por që na japin mundësi edhe të bëhemi pjesë jo-problematike e familjes së madhe evropiane.

Ministri i Brendshëm, Sajmir Tahiri , kërkonte këto ditë sugjerime në lidhje me prefrencat e qytetarëve për policinë e shtetit. Unë do i sugjeroja atij, që policia e shtetit do duhet të jetë më e rregullt dhe të trajtohen me më korrektesë punonjësit e policisë, qoftë me uniformat më serioze, qoftë edhe me rrogat më të larta dhe po ashtu, të mos nxirren në rrugë, si roje rruge, por të lëvizin me mjete të motorrizuara, duke e ndjekur krimin apo shkeljet ligjore në lëvizje, aty ku krimi ndodh.

Do kisha sugjeruar gjithashtu që Policia të bëhet më operative, duke e shpërndarë atë në 2-3 rajone të vogla, me një numër të caktuar policësh në qytet, në mënyrë që nëse krimi ndodh diku, policia të mbërrijë në vendngjarje sa më shpejt të jetë e mundur. Po kështu, policia duhet të veprojë në rrugë operative për të parandaluar krimin, që të ndodhë dhe të mos bëhet si vegël qorre në duart e ndonjë politikani, siç ndodhi në qeverisjen e mëparshme, ku Jozefina Topalli, Ramiz Çobaj etj. e përdornin policinë për presione politike ose për të kënaqur perversitetet e tyre, duke inskenuar skena përgjimi e përndjekjeje kundër kundërshtarëve, kritikëve apo konkurrentëve të tyre. Dhe në fund humbën!

Një herë, në një rast, m'u desh të shkoja në rajonin e policisë në qytetin Metkoviç të Kroacisë, i cili ndodhet disa kilometër larg fushës së Bllacës. Dera e rajonit të policisë ishte prej xhami, dhe mund të hyje aty, sikur hyn në një dyqan të rastësishëm. Se këtu tek ne, edhe shkollat e shtëpitë janë të rrethuara me mure, apo kangjella, e jo më rajoni i policisë! Pra, të përpiqemi të arrijmë standardet e vendeve që kanë qenë më afër kushteve tona dhe kanë hyrë në BE, duke e bërë edhe policinë sa më civile dhe sa më afër e hnë shërbim të qytetarëve.

Ideja e ministrit të ri të brendshëm, Sajmir Tahirit për të pyetur qytetarët, si e doni policinë e shtetit, tregon në mënyrë taktike, dëshirën e tij, që policia të jetë më afër qytetarëve, se tek kapelja e policit, qytetari i thjeshtë shikon shtetin. E zbaton polici ligjin, edhe shteti duket më serioz! Jo se ministri i brendshëm nuk di ta organizojë policinë, pasi ai ka shembuj sa të duash të policive në shtetet Perëndimore, të cilat mund t'i marrë si shembull në reformimin e policisë sonë, dhe vënien në eficencë të kësaj policiue, duke i dhënë respekt figurës së policit, duke e vlerësuar atë dhe duke i kërkuar llogari për zbatimin në çdo rast të ligjit, dhe asgjë tjetër, përveç ligjit.

Qeveria e re nuk duhet paragjykuar, siç ndodh rëndom në kulisat e partisë opozitare. Nuk duhet paragjykuar as nga media, dhe as nga shoqëria. Se është krijuar një psikologji këtu në Shqipëri, ku çdo gjëje duam t'ia gjejnë bishtin, si në telenovelat e lira latine apo turke. Jeta reale nuk është telenovelë. Ashtu siç ia dhamë shansin si popull Edi Ramës të vijë në pushtet me partinë dhe aleatët e tij, ashtu duihet t'ia japim shansin atij edhe të punojë dhe të shohim më pas se si i ushtron ai dhe qeveria e tij detyrat e marra përsipër, në rrugën tonë të pakthyeshme drejt Evropës. Le të vlerësojmë më pas punën dhe jo gunën e kryeministrit të ri dhe të qeverisë së re. Integrimi evropian kërkon standarde, jo vetëm nga qeveria, por edhe nga shoqëria jonë, kërkon edhe nga shqiptarët, të sillen si evropianë dhe me mentalitet evropian.

## Klodian Hoxha i kercenuar me jete



Ne Shqiperi ne 20 vitet e fundit jane vrare rreth 20.000 njerez te pafajshem, shkruan gazeta prestigjioze "Corriere della Sera" dhe askush nga drejtuesit e shtetit shqiptar nuk reagoi. Vetem gazeta jone e botoi shkrimin e gazetarit Ettore Mo dhe pas kesaj mjaft telefonata kercenuese anonime erdhen per gazetaret tane. Ne fakt jeta e shume shqiptareve, sidomos e veprimtareve te partisë "Levizja e Legalitetit" ka qene e rrezikuar. Eshte kjo force politike qe eshte perpjekur te ndryshoi pamjen e shtetit diktatorial komunist, ku njerezit e mafias vrasin çdo dite dhe gjykatat jane te lidhura me krimin. Nje nder keto viktima eshte edhe ky djalosh, Klodian Hoxha, nga qyteti me antikomunist, Shkodra. Qe nga nuaji janar i vitit 2009, Klodian Hoxha i bashkohet parties Levizja e Legalitetit dhe u kercenua disa here me jete, ku agjentet e shtetit diktatorial ne fund te muajit maj te vitit 2009 e arrestuan dhe e rrahen e torturuan per 24 ore ne stacionin e policies se Shkodres. Kjo dhune ishte me prapavije politike, vetem per ta larguar nga aktiviteteti politik i parties Levizja e Legalitetit. Por protesta e madhe para godines se qeverise me 21 janar 2011, ku u protestua nga me shume se 100.000 vete dhe nga policia e shtetit u vrane ne shesh kater vete, Aleks Nika, Ziver Veizi, Faik Myrtaj dhe Hekuran Deda, ishte nje dite e zeze per shtetasin Klodian Hoxha. Ai se bashku me qindra te tjere u arrestuan dhe u torturuan ne stacionin e policies se Tirane duke i akuzuar se i ka organizuar partia socialiste per te rrezuar pushtetin me dhune. Nuk i besuan se eshte anetar i parties Leviozja e Legalitetit dhe ne stacionin policor e kane rrahur e keqtrajtuar per dy dite. Pas dy ditesh tortura, Klodian Hoxha lirohet dhe detyrohet te mjekohet fshehtas ne shtepine e tij ne Shkoder, pasi spitali ishte rrezik per te. Ne Shkoder ne fakt eshte pushkatuar edhe ish drejtori i spitalit Zamir Shazi. As sot nuk eshte gjetur vrasesi. Pasiguria per jeten eshte e madhe ne spitalin e Shkodres. Por edhe ne zgjedhjet e fundit parlamentare, ato te 23 qershorit 2013 Klodian Hoxha u kercenua me jete. Kesaj here u kercenua nga partia socialiste e cila priste ta fitoi pushtetin pas tete viteve opozite. Dhe ne fakt e fitoi. Keshtu Klodian Hoxha eshte njeri nder viktimat e pafajshme te politikes se çmendur shqiptare, i cili mesojme se po jeton i fshehur nga frika sepse mund ta vrasin, si shume e shume te tjere.

**Redaksia**

# Fundi i demokracisë

Ne sot ndodhemi në një fushë të qeverisjes ku aktorët shtetëror kanë dhënë liri ndërveprimi me cilëndo palë të interesuara për të bashkqeverisur, si atë ndërkombëtare poashtu edhe atë serbe. Janë dakorduar për një lloj qeverisje shumëpalëshe me të cilën po i shkojnë për shtati konceptit të Bashkimit Evropian, ndërsa po i largohen çdoherë e më shumë konceptit demokratik. I gjithë problemi këtu qëndron se kjo "bashkqeverisje" po ndodhë jo në mardhënie ligjore, jo në mardhënie të drejta, jo në interes të popullit por në forma tjera të ndryshme kryesisht jo legjitime, aspak të drejta, dhe në dëm të popullit. Kaleidoskopi i interesave të ndërkombtarëve për arritjen e kozmokracisë po rezulton të mos jetë në interesat tona përderisa ende po dyshohet për egzistencën e Kosovës në planetin Tokë. Ndërhyrjet terapeutike të SHBA-ve dhe aleatëve të saj për çlirim të vendit e që kishin për qëllim stabilitetin në rajon po krijojnë destabilitet të brendshëm. Kjo lloj terapie po duket



se paska pasur efekte anësore/paralizuese të cilat çdoherë e më shumë po na pamundësojnë nxitjen për një zhvillim progresiv. Regresive bëhet gjendja kur pritet të legjitimohet kriminalitetit në Kosovë, kjo përmes ligjit për amnistinë e që sipas zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi na qenka pjesë e marrëveshjes përmes së cilës kërkohet integrimi i stukturave serbe të veriut në institucionet e Kosovës por që njëkohësisht do të vlejë edhe për integrimin e strukturave kriminale shqiptare në po këto institucione qeverisëse, e që duhet të votohet për hir të "parneritetit". Natali Velijaj, Xhabir Zharku, Fisnik Blakaj, Ilir Totaj, Fatmir Limaj, Nuhi Uka, djemtë e Adem Grabovcit etj, janë vetëm disa që do të përfitojnë nga ky ligj të cilët deri dje janë mbajtur nën arrest për nepotizëm, korrupsion, mashtrim, vjedhje, keqpërdorim detyre, deri edhe në sulmim fizik ndaj policëve, akuza këto që në botën demokratike do duheshin dënuar. Pa dashur të hyjë në shumë detaje të këtij projekt-ligji, më lan përshtypje disa amnisti të lezetshme sa edhe tragjikomike që kishin të bëjnë me të drejtat e kafshëve e që sigurisht i përdorën sa për të na mjegulluar vetëdijen, apo edhe për të treguar një lloj civilizimi me kafshët me faljen e krimeve të përshkallëzuara të njerëzve. Të gjithë këtë ngjarje filozofi amerikan Will Durant do e quante "pushteti i hajnave". Kur kriminelët e lumtur zgjerohen nëpër qytete për shkak se u është garantuar mbrojtja dhe bashkëpunimi total i ligjit, tregon se në çfarë shterpësie morale mund të arrijë shkalla e "demokracisë". Ai thotë se nëse këta hajna janë antarë të cilësdo parti në pushtet apo kanë shokë në të, ata mund të jenë plotësisht të sigurt se nuk do të arrestohen nëse bëjnë ndonjë krim, edhe po qe se arrestohen, nuk do të gjykohen, edhe nëse gjykohen nuk do të vuajnë dënimin, por edhe nëse i burgosin, do t'ju falet, edhe nëse nuk do të kenë falje dënimi, do t'ju lejohet të ikin. Nëse dikush prej tyre vritet derisa e kryen zanatin e vet, do të jetë i varrosur me ceremoni ashtu siç i ka hije një pjestari të shtresës së lartë dhe do t'i ngritet edhe lapidari. Nuk do të habitesha nëse ndonjë ditë do të shihja në shesh të qytetit edhe lapidarët e Xhabir Zharkut, Natali Velijat apo ndonjërit prej këtyre të amnistuarve. E këtu vërtetë do përfundonte demokracia. Qytetarë, ky ligj për amnisti do e rrënoj drejtësinë, do i rrënoj gjithë përpjekjet e atyre që punuan, luftuan, e dhanë jetën për këtë vend. Prandaj të mos e lejojmë që një gjë e tillë të ndodhë, deputetët nuk duhet t'a votojnë, deputetët duhet t`a kundërshtojnë. Të gjithë së bashku le të kërkojmë nga këta politikanë të heqin dorë nga praktikat burokratike dhe të i'a vënë zjarrin rregullave "të parregullta" të cilat po na rrezikojnë mirëqenien. Për një shtet më të mirë, për një jetë me pak dinjitet, mos e përkrahni, bashkangjituni në protestë qytetare, kundër hajnisë, kundër krimit të organizuar.

**Saranda Pajaziti**

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Razma, guri shndritës në gjerdanin e turizmit malor

Ke vendosur të bashkëngjitësh në agjendën e larmishme gjeografike të pushimeve edhe një tjetër destinacion. Në këtë bollek mundesishë që të ofron e sotmja, e dyndur tek turizmi, si mundësi dhe kapacitet i frytshëm biznesi, Razma mbetet një goditje në shenjë. Kjo piketë e re në hartën e dominimeve të ndërkallura nga dëshira për të provuar, Razma është padyshim një nga mrekullitë shqiptare të natyrës, guri shndritës në gjerdanin e turizmit malor. Një bukuri e virgjër të ndjek nga pas sapo përpjetesh në gjarpërimin për në destinacionin turistik. Një frymëmarrje e gjallë, e thellë, laroshe dhe e gjelbër, e mbush përplot me ambrozin e jetës, plazmojnë tablonë e këtij udhëtimi, kësaj ngarëndje për t'i shpëtuar vapës përvëluese që jep shpirt përgjatë kacarritjes në muret e dendura të gjelbërimit, e taftit të freskët që rigon nga qielli blu, e gufon nga humusi i vitalitetit të jetës që gjallon këndej.

Megjithëse është ndër piketat e kahershme të turizmit malor, Razma mbetet ende një mundësi pak e shfrytëzuar, një magjepsje e natyrës, pak e kundruar, një bashkëjetesë mes njerëzve me zemër të bardhë, e tubuar më shumë nga yshtje shëndetësore, sesa nga një tërbim i thellë për t'u hedhur në krahet e një aventure ngasëse. Razma është një nder pikat turistike malore më të afërta me qytetin e Shkodrës, por jo kaq e artikuluar sa Thethi, që vazhdon të mbetet një dashuri e të huajve.

Razma ndodhet e vendosur nën përkatësinë administrative të komunës së Shkrelit. Eshtë në një distancë jo më shumë se 138 km larg nga Tirana, ose 40 km nga Shkodra. Zona e Razmës është e vendosur në lartësinë rreth 900 metra mbi nivelin e detit. Pas një rrugë që gjarpëron ngjeshur në disa kthesa të dyfishta dhe me kendshikim fare të vogël, gjë që e bën të domosdoshme manovrimin me kujdes me makinë, në këtë rrugë. Është detyrues animi i pjesshëm jashtë asfaltit i automjetit ndërsa kërkon të këmbëhesh, por lëvizjet jo të dendura nuk bëjnë që ky detaj ta lëndojë udhëtimin.

Kujdes, pronoto para se të shkosh

Shpesh mëdyshjet anojnë në kahun e padëshiruar. Vija në Razëm, pas dy vitesh, si tash, me pushime. Po me një ndryshim, asohere ishte shtator dhe manaferrat ishin të pjekura dhe tash ishte korrik dhe ato ishin në lule. Kjo preferencë nga ngeli ta shijonim poshte, ndërsa lë lartësitë që të çojnë në pikën turistike, vetëm pak kilometra më tej. Ndaluam tek rezidenca e preferuar dhe pa vramendje iu drejtuam, Rafaelit, 20-vjeçarit që jeton dhe shërben bashkë me familjen. Pas një përshëndetje mes të njohurish, pa shum ceremonial ligjërimi dhe pa e çuar më mend një përgjigje mohuese, i bëra të ditur se kam ardhur me familjen për pak ditë pushim. Dhomat i kam të zëna deri në mesin e muajit që vjen, shtoi, duke mos e fshehur keqardhjen që e shkroj përnjëheresh në portretin e tij. Ngulmit tonë, për ta pyetur, se cila do të ishte adresa, ku mund të drejtoheshim për të mundësuar një dhomë ai i'u përgjigj me ngirtje supesh, ndoshta jo dhe aq se s'kishte informacion, se ku kishte dhe ku s'kishte dhoma të lira, se sa për të hezitur të japë destinacion, një rivali të tij biznesi, qoftë ky dhe xhaxhai. Fundja ç'rëndësi kishte, se pse ai hezitoi për të na ofruar një shans. Gjithsesi, duke shfrytëzuar njohjet e mëparshme mundëm të akomodoheshim në një banesë me kushte modeste dhe parapagesë. Ajo që kuptova nga gjithë kjo pjesëz e së tërës së pushimeve në Razëm ishte, se kurrsesi nuk duhej të shkoje ashtu kuturu, pa pronotuar më parë, për familjarët kjo, se aventurierët gjithnjë gjejnë se ku të fusin kokën.

Një ditë që ndryshon kah

Mbrëmja binte shpejt në Razëm. Si çdo prarim, zbriste si një pëlhurë delikate, e mbulonte me tisin e hollë shtatin e përpushur prej pasioneve të limfës. Përreth një ngrysje e thukët e mbulonte gjithë panoramën që të rrokte shikimi. Lëvizjet sa vinin dhe zhdukeshin thellë në zgafellën e mbrëmjes që lëshohej si një terr i mraztë. Dritat dhe zërat llamburisnin mes pishave shtatmesme dhe plot hijeshi. Siluetat e mbrëmjes ravijëzonin format e çrregullta të gjegrafisë së lëvizjes, në sheshin përreth fushës që shtrihej si një sofër në qendër të Razmës. Në shtëpitë e kthyera në shërbimtore për pushuesit pipëtinin biseda të ndrojtura, që tafti i freskët i mbrëmjes i përziente me një fllad që pihizte përmes halave të pishave. Nga njëri te tjetri, të gjithë vendet bujtëse të pushuesve shihje pak njerëz. Të vonuarit, darkonin dhe kundronin yjet që stërpiknin me drita shndritëse syprinën e bruztë të mbrëmjes. Hapa dhe biseda vazhdonin të përçapeshin në këto orë prarimi të ditës. Shitoret modeste që shihnin nga shëtitorja gumëzhinin nga bisedat dhe përçapjet e mbylljes së ditës. Në dhomat e bujtësve dritat njëra pas tjetrës llamburisnin, duke bërë të mundur kështu të çbusheshin rrugët dhe të niste jeta e kllapitjes.

Një muzg me personazhin e zonës

Zakonisht darkonim te shërbimtorja e tij, modeste dhe e këndshme, të cilën e kishte quajtur Bar "Kastrati". Shërbente ai, pasi në mbrëmje nuk kishte kush t'i jepte një dorë, kjo jo dhe aq ngase njerëzit e shërbimit ishin nga fshati Vrrith, pak kilometra poshtë Razmës, por se pushuesit kryesisht venoheshin në dhomate e tyre dhe s'para frekuentonin dhe aq darkimin jashtë. Sapo zumë vend, nisa ta pyes mbi zonon, si quhej ai fshati përtej, po ky grupi i shtëpive në atë lartësi, po kjo, po ajo. Pa përfunduar brëshërinë e pyetjeve të mia, Engjull Babaj, burri tipik i zonës, dhe ndër më të hershmit banorë që i kishte lidhur me Razmën jeta dhe puna, e tash biznesi, vendosi të më befasojë. Do të vini t'u tregoj një vend të bukur, pa artikuluar përgjigjen tonë pohuese, ai u drejtua nga fuoristrada që i'a kishte dërguar i biri, emigrant të Zvicër. Ndërsa ngiste makinën në një rrugë të shtruar me kalldrëm, nisi të na tregonte mbi zonën. Pas disa gjarpërimeve të rrugës e hopeve të terrenit zemërak, ku makina e tij çante përpara, u shfaq në horizont nesh një vendbanim gati mitik. Ishte si i kyçur mes lartësive të Kunorës dhe kodrave që e fillëronin. Krenazhdol, kështu quhej ai vendbanim i përkoshëm, banorët e të cilit ishin çobanë dhe të moshuar që i kishin shpëtuar kthetrave të vapës dhe zagushisë. Blegërima e deleve, këmborët dhe fishkëllimat, zërat kumbues dhe shtëpitë tipike malore, përbënin panoramën e kësaj pllaje magjepsëse. Duke qenë se ishte një vendbanim i përkohshëm, ose stanet si quhen, si shumë të tjerë në këtë krahinë e në të tjerat përreth, këtu ende nuk mkishte mbërritur drita elektrike. Nga 35 shtëpi që ndodheshin, pak prej tyre siguronin elektricitetin me gjeneratorë. Megjithatë atje jeta ngiste nën ritmin e ngjeshur të punëve dhe preokupisë. Njerëzit rrokin me afsh përjetësie çdo moment, si një një dëshmi kjo e harmonisë së natyrës me gjithseçka tjetër.

Menyja e zonës

Nëse të ka ngucatur maraku të dish se kush është specialisteti i zonës, dhe nëse këtë don ta mësosh para se të pyesësh ata që do ta ofrojë një gjë të tillë, nuk do ta kesh fare të vështirë. Mjafton të shkosh në Razëm dhe mënjeherë do të të mundësohet zbërthimi i kësaj enigma. Kudo në tabelat shpjeguese është e cituar "mish fërliku". Dhe vetëm kaq?! Ndryshe nga të gjitha zonat e tjera malore, me përparësi blegtorinë dhe që ofrojnë si servirje të para dhe kryesore mishin e pjekur, në Razëm ka edhe të tjera servirje. Patatet janë gjithashtu nga më të preferuarat dhe të kudoservirura. Turshitë, po ashtu përbënin menynë e preferuar të pushuesve dhe bujtësve. Djathrat, ku nga më të preferuarit është ai i dhisë. Rakia e dëllonjës, të ofrohet për mik. Jo më pake konsumuar është edhe vera. Për të qenë të sinqertë, gatesat nuk shoqërohen me shumë ceremonial dhe përgatitja e tyre nuk ka shumë ojna. Kjo e bën edhe të veçantë drekimin këtu, pasi pjesa dërmuese e bujtësve vijnë nga zonat urbane ku nuk mungon ceremonailitetì, salltaneti dhe padyshim çmimet e kripura.

Fundjavat e mbipopulluara

Një veçri që e tipizon Razmën është dhe kthimi i saj një epiqendër e kalimit të një fundjave pranë qingjit që piqet në hedh, e nën shoqërini e pijes dhe shakave, lojrave dhe hokave. Nga Tirana, Shkodra, Laçi, Mati, Mirdita, Malësia e Madhe, bujnë në Razëm për fundjavë. Zakonisht ata pronotojnë menunë që mbetet mishi i pjekur dhe për të tjerat nuk kanë asnjë vramendje. Vijnë afër mesditës dhe ikin kur dilli ka rënë pas supeve të maleve me pisha dhe ahe. Shumë prej bujtësve të fundjavave vijnë dhe për gjueti, natyrisht kur është sezoni i hapur.

Fenomeni i shtëpive të braktisura

Ajo që një pushuesi në Razëm nuk do ti shpëtojë pa e vënë re, janë shtëpitë e braktisura. E përcaktojmë e braktisur, pasi prej vitesh nuk banon askush në to, por ato kanë pronarë dhe zotër. Gjithsesi të bie në sy një veçori e këtyre ndërtimeve që datojnë që në vitet 1930, madje edhe më heret. Arkitektura e përdorur dhe tërësia e komfortit të banesës, vilës nëse mund ta quajmë kështu, është një përzierje stilesh. Të gjitha ishin me ballkon dhe me pak këmbë shkallë që përqarkoheshin nga parmakë të dizenjuar. Hauri për bagëtinë dhe për bazën ushqimore, oborri që i vinte qark shtëpisë, vendosja në pika dominuese të terrenit, murët dhe mbuloja, dekoracionet e përdorura, të gjitha këto vërtetojnë se këto banesa ishin, siç citohet edhe në Wikipedia, të tregtarëve të Shkodrës, të cilët me sa duket i kishin ata si shtëpi pushimi verore dhe dimërore. Klima e shëndetshme dhe distanca jo shumë e largët nga Shkodra, i bënin ato një vend pushimi të prëferuar. Asnjë mëdyshje nuk ka se ndërtimi i atyre banesave ishte fillimi i historisë së Razmës turistike. Falë atyre burrave, jo vetëm me para, por edhe me shije dhe pasion, kemi sot një destinacion. Razma është vendi ideal për të rigjetur vetveten, larg nga zhurmat dhe nga stresi i qytetit. Në qetësine e mrekullueshme të maleve, e thyer vetëm nga kenga e zogjve dhe nga era që fëshfërinë mes gjetheve të pemëve. Është kjo që zotërit e këtyre shtëpive kanë ditur dhe gostirur përmes atyre shtëpive, tq cilat edhe në atë gjëndje mjerane që janë kanë shumë për të thënë. Resurset natyrore. Relievi i Razmës ndërtohet tërësisht prej shkëmbinjve karbonatikë të mesozoit me një strukturë bllokore tipike të ngritur mbi 1500 m lartësi, shkalla e lartë e tretshmërisë së këtyre shkëmbinjve ka bërë që në relievin alpin të Razmës, vendin kryesor ta zërë morfologjia karstike. Ky reliev përfaqësohet nga fushat (e Razmës, Troshanit, Fusha e Zezë) në trajtën e gropave, hinkave dhe shpellave karstike ku këto të fundit përbëjnë një objekt turistik me vlerë për eksplorimin e tyre. Gjurmët e veprimtarisë së akujve të kuatërnarit i gjejmë në Fushën e Zezë, atë të Razmës, dhe depozitive midis Razmës e Vrithit. Format më të mprehta të relievit me vlera turistike (alpinizëm, piknike etj) në këtë zonë i përkasin kurrizit malor Veleçik (1724 m) – Kunorë (1713 m) në veri të Razmës dhe Kunorës së Zagorës (1862 m) në lindje të saj. Relievi malor i Razmës me pyjet impresionuese të ahut e pishës, ajrin e pastër dhe të freskët sidomos gjatë verës e dimrit, përmban në vetvete vlera turistike të veçanta. Larmia e kafshëve dhe e shpendëve të egjër në këtë zonë, përbën një mundësi të mirë për zhvillimin e gjuetisë.

Destinacionet që mundësohen. Razma, si shumë destinacione të tjera të gjerdanit të turizmit malor të Veriut të Shqipërisë, kanë specifikimin e tyre, që përbën dhe veçantinë që i karakterizon ato. Llojshmëria e objektit të këtij destinacioni janë; Turizëm shkencor (gjeografik, turistik, historik, etnografik, biologjik, zoologjik, spelologjik). Turizmi gjeografik me larminë e objekteve gjeografike në majat e ndryshme të kësaj zone si maja e Veleçikut, maja e Kunorës, etj.. Turizmi gjeologjik me karakteristikat gjeologjike të kësaj zone, mund të themi se depozitimet e ndryshme të mesozoit, të kenozoit dhe në pjesën më të madhe të kuaternarit si dhe thyerjet tektonik tërthore e afrogjatësore të kësaj zone kanë një interes studimor për studiuesit e kësaj fushe.

# Malesi e madhe. Dhunohet demokristiani Angjelin Pllumaj, 4 vjet më parë u vra kryetari i PDK-se Aleks Keka.



Malesia e Madhe eshte zona ku veprimtarët e Partise Demokristiane janë dhunuar fizikisht, janë kërcënuar me jetë, e deri janë vrare. Edhe në zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit 2013, ku Partia Socialiste fitoi me dhunë, tensionet kanë qënë shumë të ashpra. Demokristiani i njohur Angjelin Pllumaj, pak më shumë se një muaj para zgjedhjeve, u dhunua fizikisht dhe u la pa ndjenja nga gjashtë persona që përfaqësonin Partinë Socialiste. Data 20 maj 2013, pasdite, demokristiani Angjelin Pllumaj, banor i fshatit Selcë, komuna Kelmend, Malesi e Madhe, teksa po kthehej në shtëpi te vet nga një takim që kishte patur tek zyrat e PDK-së me anëtarë të Forumit Rinor të kësaj force politike, është dhunuar nga gjashtë anëtarë të Partisë Socialiste. Demokristiani Pllumaj po udhëtonte me makinë me dy persona të tjerë, ku njëri prej tyre ishte në timon. Gjashtë socialistët u kanë bllokuar rrugën dhe e kanë kërcënuar se nëse Angjelin Pllumaj nuk e mbyll gojen ata do ta vrasin. Demokristiani Pllumaj u ka thënë se ai do vazhdoi punën e vet, pasi beson tek parimet e shenjta të Partisë Demokristiane dhe se kjo parti parlamentare është një parti me vlera njerëzore e se don vetëm paqë, vëllazëri dhe të ndikojë për një Shqipëri europiane pa dhunë e me liri e të drejta njerëzore. Kjo gjuhë kaq e qetë e demokristianit Pllumaj i acaroi edhe më shumë gjashtë personat që po e kërcënonin. Kështu e nxorrën nga makina dhe e rrahën shumë rëndë me shkop dhe grushta në gjithë trupin. E kanë shtrirë për tokë dhe e kanë gjuajtur me shkelma. Kjo dhunë ka zgjatur 10-15 minuta dhe më pas janë larguar. Para se të largoheshin e kanë paralajmëruar edhe njëherë se do vrasin po të vazhdoi të punoi per Partinë Demokristiane. Demokristiani Pllumaj ka marrë plagë dhe i janë shkaktuar të nxira në trup. Nuk e ka raportuar në polici dhunën, pasi nuk besonte, madje dyshonte se edhe policia i mbron kriminelët. Ai ka marrë trajtim mjekësor nga mjeku Adrian Këlliçi në banesën e tij në fshatin Selcë, Komuna Kelmend, Malësi e Madhe, pasditen e datës 20 maj 2013. Sipas mjekut, pacienti nuk ka pranuar të shkoi në spitalin rajonal të Shkodrës, pasi kishte frikë se e ndiqnin dhunuesit. Në fakt edhe në spitalin e Shkodrës ka patur ngjarje ku edhe janë pushkatuar mjekët jo më pacientët. Ka ndodhur që në operacion, me bisturi në dorë, është pushkatuar mjeku Zamir Shazi. Pra, mjeku Këlliçi e ka trajtuar për një periudhë disa ditore dhe më pas demokristiani Angjelin Pllumaj ka qëmdruar i fshehur nga frika e vrasjes. Kishte ndodhur në fakt që në zgjedhjet e kaluara parlamentare, ato të 28 qershorit 2009 ishte vrarë kryetari i PDK-së Malësi e Madhe Aleks Keka. Edhe atëherë vrasja kishte ndodhur dhjetë ditë para zgjedhjeve, pra më datën 18 qershor 2009 në aksin rrugor Koplik-Shkodër rreth orës 09.45 minuta, makina Mitsubishi Pajero me targë SH 2125 E ka shperthyer në ecje nga një minë me telekomandë ku ka vdekur në vënd Kryetari i PDK-së Malësi e Madhe. As sot ngjarja nuk është zbardhur dhe organet e hetimit e kanë mbyllur dosjen, duke e regjistruar këtë si një ngjarje pa autor. Pra demokristianët në Malësi të Madhe kanë qënë dhe janë shumë të rrezikuar me jetë.

**Redaksia**

# Kur dashuria kthehet në tragjedi



Dashuria mes te rinjve e te rejave të feve te ndtyshme në Shqipëri, është një femomen që shume dashuri të tilla i ka kthyer në tragjedi. Kjo ka ardhur për faktin se komunitetet myslimane dhe katolike nuk pajtohen kurrsesi, sidomos në rastet kur vajza martohet me një të fesë tjeter. Pra, problemi kryesor është familja e vajzës, pasi djali nusen mëndohet se e kthen në fenë e vet. Kështu ka ngjarë me të riun Adriatik Ali Sufaj, i cili u dashurua me të renë Eliverta Çuni. Duke qënë djali i besimit mysliman dhe vajza e besimit katolik, disa vite më parë djali u detyrua ta grabitë të dashuren katolike per të krijuar një jetë dhe një familje të mirë. Duke qënë se familja Çuni nuk ia falte kurrsesi "koritjen" vajzës, çifti në vitin 2008 u bë me fëmijë, me një djalë, duke mënduar se familja e vajzës do zbutej dhe nuk do kërkonte ta vrasë vajzën e vet që është martuar pa dëshirën e saj me një të fesë myslimane. Ky çift, megjithëse jetonte i fshehur që nga dita që vëndosën të lidhin jetën bashkë, nga frika se do vritej thjesht se ishin të dashuruar, lindën edhe një djalë tjeter në fillim të muajit maj të 2013-tës. Por prapë familja e vajzës nuk hiqte dorë nga hakmarrja, pasi e vlerësonte si të humbur "nderin", pasi vajza jetonte me një të fesë tjeter. Familja Çuni është ndër ato familje që edhe në vitin 1968 kishte patur një rast si ky. Një vajzë e kësaj familjeje, e quajtur Lulë Çuni ishte dashuruar me një oficer të Policisë së Shtetit, të fesë myslimane. Familja Çuni ka qënë e persekutuar nga regjimi komunist i Enver Hoxhës, e megjithatë arriti aso kohe dhe vrau vajzën e vet Lulë dhe të dashurin e saj të quajturin Rexhë Mehmetaj. Kështu pra do ndodhë edhe me rastin e martesës së vajzës së tyre Eliverta Çuni me të riun Adriatik Ali Sufaj që megjithëse u fshehën e jetuan në ilegalitet për shumë vite, u bënë edhe me dy fëmijë, prapë nuk i falën, duke ecur në traditën patriarkale se vajza u ka ndërruar fe. Prandaj ky çift mësojmë se ka marrë rrugët pa kthim nga frika se plumbi i vret, thjeshtë se dashurojnë njëri-tjetrin dhe e duan jetën si njerëz të lirë e pa asnjë paragjykim.

**Redaksia**

# Qylxhinjtë e lëvizjeve qytetare

Para disa ditesh e takova rastesisht Albin Kurtin, kryetarin e "Vet vendosjes", por ne pak minuta pata rastin te bisedoj me njerin prej personave qe e shoqeronte ne viziten ne SH.B.A. edhe ky deputet i kuvendit te Kosoves.

- Ju a e njhni partine tone dhe programin e saje..? mu drejtua deputeti i "V.V."

- Po ju pergjigja, e kam njohur atehere kur meritonte njohje e mirnjohje, kur ishte nje levizje e fuqishme atdhetare, nje zgjim i ndjenjave dhe pergjegjesive kombetare. Une i kushtova edhe nje kange te cilen e ka kenduar ne Kosove kengetari i mirnjohur Gezim Nika:

«Fluturon Shqipja me flete,
Ne Flamurin kuq e zi.
Bijte e mi vendosin vete,
Per nji komb, nji Shqiptari"..

etj.. Frymezimi i kesaj kange me erdhi pikerisht nga "Vetvendosja"

- E kam degjuar "live" kete kange,me tha zoteria, ka patur nje jehone mjafte te madhe. Po tash gjate kohes si parti parlamentare si ju duket qendrimi yne..?

Eh.. ju pergjigja: - Tash kam mendim tjeter. Parti kishim boll e teper..! Shqiperia dhe Kosova kane nevoje per fryme opozitare nga pozita qytetare. Aty ku e mbyte frymen civile, pergjegjesine dhe reagimin qytetar politizimi, aty fillon qytetari-mjerimi, aty degradon reagimi nga pozita civilizimi.

U ndame miqesisht, mbasi me njoftaun se ate nate ne nje lokal ne Detroit kishin nje takim, dhe une urova t'ja kalonin mire, ashtu siç kam uruar pergjate 17 viteve ne distance takimet e politikes me emigracionin, pa marre pjese ne asnje prej tyre.

Kur po kthehesha rruges per ne shtepi, mendova ne "detaje" per qylaxhinjte e levizjeve qytetare, dhe demet serioze qe ata i kane sjelle shoqerise Shqiptare.

Levizja "Mjaft" kujtohet mjaft mire per sherbimin e madh qe i solli shoqerise, per sa reagimi i saje ishte qytetar, reagim ndaj te keqes nga pozita te pergjegjeshme civile. Por duket se kjo nuk i mjaftoje Erion Velajt, i cili nga kjo levizje mendoje te merrte "qyl" perkrahjen dhe ndonje vote per karieren e tije ne politike, dhe mbas shume mundimesh nje liste ja dha karrigen e deputetit. Levizja mjaft mbaroi. Qytetaret u zhgenjyen.

Nje Kreshnik doli ne skene dhe filloj te "kreshperohej" ne krye te "Aleances kuq e zi"

Kishte mbetur nje "ograje e pa kullotur" nga politika Shqiptare pergjate ketyre viteve, dhe Kreshniku nga majat e drejtesise (KLD) e "pikasi" kete padrejtesi.

Zgjimi i frymes kombetare ne kohen kur ziente paknaqsia per "Marveshjen e detit" dhe regjistrimin e popullsise me vet-deklarim feje dhe etnie, siguroj ne nje kohe rekord perkrahje e cila erdhi duke u rritur me parullat Nacionaliste te bashkimit te trojeve Shqiptare, nje enderr e vjeter dhe e denuar me se shumti nga poli-perçarjet Shqiptare ne momentet "deçizive"




«Uragani kuq e zi» u rrit ne prag te 100 vjetorit te shpalljes se pavarsise, nuk u demtua as kur ju shtua akuza ndaj qeverise per korrupsion, por filloj te "venitej" pikerisht kur Kreshniku i KLD(Kapercim i ligjeve dhe drejtesise) filloj te therriste ne mitingje:- "Mbas 23 Qershorit, shtetasi BERISHA-NE BURG" pra me nje urdher, duke mos njohur asnje institucion drejetesie qytetaret te "rraseshin" ne burg, qofshin keta edhe ish-presidente, ish-kryeministra..!

Lajthitjet filluan pikerisht kur "AK" u kthye ne parti politike, kur reagimet atdhetare, civile qytetare duhej te ktheheshin ne "vija uji" per mullirin e politikes Kreshnikase, ne vota per kapardisje kreshnikase ne parlament.

Qytetaret e dhane mesazhin e tyre te heshtur. Tek kutia mori fund Kreshnikeria, por per fatin e keq mori fund edhe nje levizje qytetare, degradoj edhe ajo si ato te me pareshmet. Ky eshte nje dem kolosal qe keta njerez i kane sjelle opozitarizmit te pa anshem qytetar ndaj se keqes qe vjen nga çdo krah i politikes.

Nje vend pa organizim te reagimit civil qytetar, pa veprim te organizuar sindikalist (sindikatat tona jane te ndara ne sindikata-servile, dhe sindikata-spekulante, pro dhe kunder pushtetit) demokracia lengon me thonjte e politikes ne fyt, ku behet vetem nje beteje:- Per te mbajtur ose per te marre pushtetin, duke livadhisur mbi shoqerine e cila e ka humbur reagimin, ka humbur edhe besimin e organizimit pikerisht per shkakun e qylaxhinjeve te levizjeve qytetare. Kjo eshte nje humbje e madhe per shoqerine, per demokracine e vertete, per ndjeshmerine dhe pergjegjesine qytetare e cila nuk beson tjeter ne keto vlera, per shkakun e keq perdorimit te tyre.

**Gjovalin Lumaj**

# Promovohet vepra e re e studiuesit Mentor Quku "prof. Mustafë Dervishi" dhe përkujtohet jubileu i 70- vjetorit të vrasjes së tij

Më 27 korrik, ditë e shtunë, pasdite, në sallën e konferencave të Grand Hotel Europa u zhvillua një mbledhje promovuese dhe përkujtimore njëkohësisht. Ishte rasti i promovimit të librit të ri të studiuesit të njohur Mentor Quku "Prof. Mustafë Dervishi, studim monografik mbi jetën dhe veprën".

Pavarësisht nga të nxehtit e madh dhe ditët e pushimeve verore, kishin ardhur për të marrë pjesë në këtë tubim shumë qytetarë, përfaqësues të lartë të klerit musliman, shkrimtarë, studiues, historianë, gazetarë dhe punonjës të mediave televizive. Kishin ardhur për të marrë pjesë edhe studiues nga Tirana, Ulqini, Lezha, e të tjerë vise jashtë Shkodrës. Interesimi i madh buronte nga se promovohej një vepër e një profili të ri, e punëtorit të palodhur të shkences se mjedologjisë që asnjehere nuk reshti së rënduri në kërkim të së vërtetes, të fakteve historike të pakontestueshme.

Në faqet e para të veprës "Prof. Mustafë Dervishi", autori i librit kishte zgjedhur me vend citatin latin "E ëmbël dhe e hijshme është të vdesësh për Atdhe", i cili shprehte në thelb veprimtarinë e një djaloshi intelektual që nuk e kurseu as jetën për lirinë e atdheut, me gjithëse kishte përpara një të ardhme dhe një karriere të shkëlqyer. E veçanta e këtij tubimi ishte se promovimi i veprës së re të Mentor Qukut, u bë në kuadrin e përkujtimit të jubileut



të 70-vjetorit të vrasjes të profesorit, intelektualit, patriotit, nacionalistit antikomunist dëshmorit të atdheut prof. Mustafë Dervishit. Mbledhjen përkujtimore e drejtoi studiuesja Fatbardha Saraçi Mulleti, e cila e filloi me hymnin e Flamurit Kombëtar.

Më tej ajo ua dha fjalën ligjëruesve të cilën vlerësuan veprën e re të Mentor Qukut, si edhe aktin madhor të Profesor it Mustafë Dervishi. Studiuesi Nexhmi Busahti theksoi karakterin e veçantë të këtij tubimi, sepse nuk ishte një promovim rutinë i një libri të zakonshëm, por i një studimi kushtuar një biri të shquar të Shkodrës, një përfaqësuesi "par excellence" të brezit të ri të intelektualëve shqiptarë të viteve '40, mbi të gjitha i një martiri të lirisë së atdheut. Shkrimtarja Fatbardha Saraçi (Mulleti), që e mori fjalën më pas, u ndal kryesisht në mbresat që i ka lënë leximi i librit të ri Mentor Qukut.

Studiuesi i njohur, lëvruesi i palodhur i kulturës kombëtare, shefi i sektorit të kulturës së Komunës së Ulqinit, Dr. Nail Draga, foli për punën e palodhur të autorit të veprës që promovohej, si edhe kontributet e bashkëpunimet që kishin pasur kohë më parë për ndriçimin e figurave të shquara kombëtare, si Cafo Beg Ulqini, Musfafë Dervishi etj. Vlerësime të larta bëri shkrimtari Skënder Drini për veprën e Mentor Qukut dhe për mesazhet që jep kjo vepër sot në shoqërinë shqiptare. Ai u shpreh se vrasja e nacionalistit Prof, Mustafë Dervishit ishte vrasja e nje shprese për rininë shqiptare.

Më pas e mori fjalën studiuesi dhe historian Uran Butka, i cili e vuri theksin në veprimtarinë patriotike të profesorit të ri Mustafë Dervishi në Gjimnazin e Shtetit në Shkodër, me tradita për veprimtarinë liridashëse të studentëve dhe profesorëve. Gjithashtu ai u ndal në veprimtarinë e këtij heroi në drejtimin e Qarkorit të Ballit Kombëtar të Shkodrës dhe bashkëpunimin me profesorët e njohur Safet Butka, Anton Deda, Kolë Margjini, etj. Duke folur për Prof. M.Dervishin, theksoi se ai ra si intelektual e jo si luftëtar i thjeshtë, vrasja e tij ishte goditje kundër nacionalizmit e patriotizmit shkodran e atij shqiptar në tërësi. Emri e vepra e tij do jetojë derisa të jetojë shqiptarizmi.

Me ketë rast e mori fjalën për të përshëndetur tubimin edhe kryetari i Ballit Kombëtar Demokrat, Artur Roshi, i cili kërkoi që rinia e sotme të mësojë nga mesazhet e heronjëve të Ballit Kombëtar si Mustafë Dervishi. Përshëndeti gjithashtu anëtari i Këshillit të Bashkisë Shkodër, Xhemal Shkjau, i cili bëri kërkesën që figura e këtij martiri duhet të nënvizohet me nderime të mëdha nga pushteti qëndror dhe ai lokal. Sipas traditës e mori fjalën edhe autori i librit Mentor Quku i cili falenderoi pjesëmarrësit, organizatorët si edhe ligjëruesit. Në fjalën e tij ai u ndal në mesazhin e veprës së tij, që është sot më aktual se kurrë, bashkimi i popullit, shëmbja e murit të urrejtjes në mes të inidividëve apo grupimeve shoqërore me pikëpamje e përkatësi të ndryshme.

Autori i veprës Mentor Quku e mbylli ligjeratën e tij me thënjen lapidare "Sa më të ndryshëm aq më të bashkuar duhet të jenë Shqiptarët". Mbledhja promovuese dhe përkujtimore u mbyll me fjalën e vëllait të heroit Prof. Mustafë Dervishit, mësuesit në pension, Hamza Dërvishi, i cili falenderoj autorin për punën e realizuar si çdoherë me perkushtim që është nje gur në themelin e murit të lavdishëm të historisë të ndërtuar me gjakun e idealistave që u vetsakrifikuan për mëmëdhenn. Jeta dhe vepra e Prof. Mustafë Dervishit nuk duhet vetëm të perkujtohet por dhe të ndiqet nga brezi i ri, të shërbejë si frymëzim që demokracinë e vërtetë ta ndërtojme me vepra e të jemi të ndërgjegjshëm që vetëm ne mund ta bejmë siç duhet. Së fundi të gjithë pjesëmarrësit morën si dhuratë librin e sapopromovuar.

Prof. Mentor Quku i perket atyre njerzeve qe dine te bajne pa vdeksin, veprat e prof M. Qukut kane gjetur lexueshmeri deri ne SHBA e kudo tjeter. Prof.Mentori tregoje aktin human te nji njeriu me mendje dhe zemer te madhe,te gjithe te pranishemve ju beri dhurat nga nji kopje te librit ma te ri,I cili u promovue ne qytetin e Shkodres.

**Gjin Musa**
ish nxanes i M. Qukut

Shqipëria Etnike

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.

e shtunë
10 gusht 2013



# Operohet gabim në Zvicer, spitali përpiqet të falsifikojë dokumentet, tentojnë edhe ta vrasin që të mos flasë.

*INTERVISTË E ISMAJL QERIMIT NGA VUSHTRIA E KOSOVËS DHËNË GAZETARIT TONE ARBEN LAGRETA*

Ismajl Qerimi nga Vushtria e Kosovës flet për dramën e shumëfishtë që po përjeton që prej afro një dekade, ku pas një aksidenti në punë, u operua në mënyrë joprofesionale dhe për më tepër pa praninë e specialistit anestezist. Kjo ndërhyrje kirurgjikale rezultoi e pafalshme sipas specialistëve që e vizituan më vonë. Kushdo që e ka lexuar romanin "Rrethi i kujtesës" të Diana Culit, do t'i dukej më normale eksperimentimi me medikamente që i bëhej në një klinikë naziste një partizaneje shqiptareje në vitet e Luftës së Dytë Botërore në raport me kalvarin dhe privimeve që ka hequr dhe vazhdon të vuajë Ismajli në vitet '2000. Sepse, si për ironi të fatit, Ismajli nuk jeton as në Ruanda, as nën regjimin e Mugabesë dhe as në ndonjë republikë të humbur bananesh por në zemër të Europës. Në një shtet që po i afrohet 800-vjetorit të formimit të tij dhe konsiderohet si model në funksionimin e demokracisë në shkallë botë rore. Pikë risht në Konfederatë n e Zvicrës.

Zhgënjimi i tij më i madh do të vinte më pas si pasojë e diskriminimit, antihumanizmit dhe presioneve që ka përjetuar për të mbyllur gojën dhe për të mos ta publikuar këtë skandal. Historia e tij e dhimbshme është e vështirë të përshkruhet nëpërmjet një interviste sepse ai po vuan familjarisht pasojat e papërgjegjshmërisë së bluzave të bardha si dhe të përfshirjes së tyre indirekte në presione me qëllim për të heshtur për këtë skandal. Ismajli rrëfen me një kujtesë të admirueshme fakte dhe detaje, të cilat vërtetohen nga dokumentet origjinale që ai posedon dhe m'i vë në dispozicion. Në këto kushte arrita që të bindesha plotësisht se këtu kemi të bëjmë me një skandal, pavarësisht faktit se me të komunikoj ende nëpërmjet internetit on-line dhe jo drejtpë rdrejt. Në kushtet e një dëshpërimi dhe ankthi të tejskajshëm që ai ndien cdo ditë jo aq për vete se sa për pasigurinë e familjes së tij, Qerimi i është drejtuar tashmë Gjykatës Europiane të Strasburgut ku edhe ka depozituar dosjen e çështjes së tij me të gjitha provat, pas zvarritjeve përtej afateve ligjore të parashikuara nga Gjykata e Kantonit të Vaudit. I dëshpëruar për nëpërkëmbjen që po i bëhet në Zvicer, Qerimi thotë se në rast se e drejta e tij nuk do të shkojë në vend shumë shpejt ai do të fillojë familjarisht një grevë urie përpara një prej institucioneve kryesore të shtetit ose atyre ndërkombëtare të instaluara prej shumë kohësh në Zvicër. Pasi informohesh dhe komunikon me Ismajlin për kalvarin e vuajtjeve të tij të njëpasnjëshme si dhe shkaktarët të cilët ai i akuzon direkt, atëherë kushdo mund të kuptojmë më mirë ekzistencën në shtetin helvetik të frymës raciste antishqiptare, e materializuar kjo vitet e fundit me monstra të tipit Carla del Ponte apo Dick Martin.

Ndërkohë Qerimi shprehet i gatshëm që të përballet me cdo gjykatë në lidhje me pohimet dhe akuzat e rënda që ai ngre në këtë intervistë, madje duke u vënë në dispozicion që t'i nënshtrohet edhe provës së makinës së të vërtetës, ashtu si në SHBA/ Dhe, në mbyllje të këtij prononcimi, duke konsideruar si më efikase dhe më me peshë në arenën ndërkombëtare institucionet e shtetit shqiptar në raport me ato të Kosovës, ai i bën thirrje për ndërhyrje në përmjet autoritetit shtetëror dhe kanaleve diplomatike edhe Kryeministrit të Shqipërisë.

Nisur nga kjo situatë emergjente e Qerimit, në një nga aktivitetet me karakter politik ku isha i ftuar në Tirane gjate ketij muaji më rastisi që të prezantohesha me Zëvendëskryeministrin e Parë të Kosovës dhe Kryetarin e AKR-së zotin Behgjet Pacolli si dhe Zv/Kryeministren tjetër, znj. Mimoza Kusari. Nisur nga fakti se z. Pacolli ka edhe nënshtetësi zvicerane por edhe një ndikim më të fortë se një politikan i zakonshëm fale aktivitetit të tij të suksesshëm si biznesmen në shtetin helvetik, I fola shkiurt me aq pak kohë sa kisha mundësi në atë ambjent me njerëz në hotel Sheraton, problemin akut të bashkëatdhetarit Ismajl Qerimi. Zoti Pacolli reagoi pozitivisht sepse i kisha shkruar për këtë problem një deputeteje të partisë së tij…

**Kush është Ismajl Qerimi, kur erdhët ne Zvicer, per c'arsye dhe si u integruat?**

Në radhë të parë ju falenderoj për mundësinë që po më jepni për të komuni-





kuar me publikun nëpërmjet kësaj interviste. Quhem Ismail Qerimaj dhe jam nga Dumnica e Vushtrisë në Kosovë ku edhe kam lindur më 1975. Lashë Kosovën në vitin 1992 për arsye politike si pasojë e shtypjes dhe e represionit të atëhershëm dhe në vitin 1993 kam ardhur në Zvicër ku më priste vëllai im i cili kishte emigruar më parë. Pas një viti fitova statusin e refugjatit politik dhe u vendosa në kantonin e Vaudit. Gjatë këtij viti u integrova mjaft mirë profesionalisht dhe u vendosa këtu përfundimisht.Në vitin 1997 u njoha më Isabela Pereira, një vajzë e mrekullueshme me nënshtetësi franceze dhe origjinë portugeze, me të cilën edhe u martova në vitin 2000 dhe kemi një djalë 8 vjecar, Adrin. Unë fillova punë në postën zvicerane ndërsa bashkëshortja ime ka punuar menaxhere biznesi në lavanderi.

**Tani le te ndalemi ne aksidentin që ju ndodhi në punë. Si ndodhi?**

Aksidenti ndodhi më 26 nëntor të vitit 2003 kur një pako me peshë afro 30 kilogram më ra në dorën e majtë nga një lartësi prej 4-5 metra. Shefi me dërgoi urgjentisht në Poliklinikën Vidymed në Lozanë. Dy mjekë më kanë kontrolluar, Dr. Moeri dhe Dr. Stuzenegger, të cilët, me anë të radiografisë, gjetën lëndim të damarit të syrit dhe të një kisti palmaire radiale (një lloj palme muskulore). Nga kjo ditë kam ndërprerë punën duke marrë ilace kundër dhembjeve.Në mes kohës, gjatë përcjelljeve mjeksore, më është dhënë një injeksion për të m'i ndaluar dhimbjet në dorën e majtë, gjë që më ka mundësuar që ta rifilloj punën në shkurt të vitit 2004. Kështu, pas disa muajve, Dr. Moeri dhe Dr. Stuzeneger, më sugjeruan që t'i shtrohem një ndë rhyrjeje kirurgjial, i cili mu bè më 22 shtator 2004 në klinikën La Source. 3 ditë para operimit më komunikuan pushimin nga puna…

**Gjatë bisedës theksuat disa herë se ky operacion rezultoi fatal për juve. A mund të na shpjegoni në mënyrë më të kuptueshme për lexuesin se c'farë ndodhi me ju?**

Në cdo operacion pacientit i mundësohet prania një mjeku anestezist por kjo nuk ndodhi me mua. Unë jam vendosur direkt në sallën e operacionit dhe një infermiere erdhi për të luajtur rolin e anestezistes. Këtë e vërteton edhe deklarata e firmosur nga mjeku i amnestezisë Dr. Pierre Ledermann, i cili, në dijeni profesionale të kësaj ndërhyrjeje të papërgjegjshme kirurgjike ndaj meje, pohon se nuk ka qenë i pranishëm në operacionin tim, cka dhe është e vërtetë. Prandaj edhe vendosja e emrit të Dr. Ledermann si i pranishëm në protokollin e hartuar nga ana e Stuzenegger dhe mosvendosja e emrit të infermieres Sabine Noel e cila në të vërtetë e zëvendësoi atë, ka qenë një tentativë e pastër për të fallsifikuar dokumentet. Kjo për arsye se Stuzenegger ka qenë i ndërgjegjshëm se zëvendësimi i një mjeku anestezist me një infermiere në sallën e operacionit përbën një shkelje të rëndë ligjore. Ju keni në dispozicion edhe dokumentin e këtij protokolli që vërteton këto që sapo ju thashë. Vetë mjeku anestezist Pierre Ledermann duke mohuar me anë të një deklarate të firmosur pjesmarrjen e tij në operacion i lë në dorë dopjogjashtën Dr. Stuzenneger pasi ai nuk kishte përse të mbante përgjegjësinë e paaftësisë së tij, për më tepër që dihet se si u përkeqësua gjendja ime shëndetësore pas operacionit. Ndërkohë mjeku kirurg Dr. Michael Stuzenegger filloi menjëherë operacionin kure eka pare se anestezia antervenoze nuke ka patur efektin e vet sepse aj vetum kishte filluar operacionin dh nuke kishte mundesi te kthehet mbrapa dhe ka kerkuar te aplikoi infermeres anestezinë lokale nën sqetull. E vetmja zgjidhje per te vazhduar operacionin, por qe të ishte aj mjeke. I sinqerte dhe korekt nuk u duhej te vazhdonte operacionin në kushte te tilla pa prezencen e aneseonit. Kam ndjerë një dhimbje të padurueshme, dora më ishte mpirë fare. Ishtë një torturë e vërtetë dhe e mbaj mend mirë se kam ulëritur nga dhimbja. Kirurgu ishte në panik dhe i bërtiste infermieres në një kohë që në vend të saj duhej të ishte anestezisti. Ai vazhdoi operacionin në dorën time dhe kjo shënoi fillimin e një makthi të gjatë për mua. Pas operacionit jo vetëm ndjeja dhimbje të konsiderueshme dhe reduktim të ndjeshëm të forcës në parakrahun e majtë.

**Si rodhën ngjarjet pas kë tij operacioni?**

Që nga ky operacion shëndeti dhe jeta ime pèsuan njè traumë fizike dhe psiqike. Nga dhembjet u detyrova menjëherë pas operimit që të kërkoj ndihmë mjeksore në urgjencë, ku për të dytën herë, më kanë aplikuar morfinë kundër dhembjeve, dhe aty mjekët më thanë se duhet të konsultoj kirurgun tim sepse këto dhembje nuk janë normale. Pas konsultimeve me Dr. Sturzenegger, shkova te Dr. Huggenbuhler, i cili më bëri ekzaminin EMG, i cili konstaton se nuk ka përmirësim. Kirurgu im, kësaj here, më propozon një rioperim, duke dyshuar se operimi i nervit carpien ishte gabim, por duke u arsyetuar se duhet konsultuar sigurimin e aksidenteve, SUVA (Sigurimi Aksidental Profesional ne Zvicer) për ta përcjellur gjendjën shëndetsore, gjegjësisht të dorës sime. SUVA më propozoi një klinikë speciale për riadaptim në Sion… Në këtë klinikë, iu jam nënshtruar seancave fizioterapive dhe ergoterapive të papërshtatshme të cilat më kanë dëmtuar duke ma paralizuar grushtin të cilin nuk kam mundur ta hap. Duke u përpjekur që të ma hapin grushtin, ata kanë praktikuar shumë infiltrime injeksionesh në muskuj (si Calcitonine, Botoxe e Redia), por që nuk kanë pasur asnjë sukses. Mjekët e SUVA-s nuk e kanë marrë seriozisht gjendjen time shëndetësore, madje ata më kanë quajtur stimulues (!!!). Për injorimin e shërimit tim, nga ana e mjekëve, i kam njoftuar edhe anëtarët e familjës sime. Unë kam insistuar me këmbëngulje se përse më mbajnë, të mbyllur si një jetim, duke më keqtrajtuar me sjelljet e tyre vulgare dhe agresive…Pas insistimit tim për kontrolle më profesionale, ata më në fund ranë në përfundimin se diagnoza ime ishte "algoneurodystrophie ?". Mjekët më thanë se përmirësimi i gjendjës shëdetësore do të bëhët me kalimin e kohës. Gjatë qëndrimit tim në klinikën e Sionit, dhembjet e mia nuk kishin pushim, për çka edhe u kërkoja ndihmë infermiereve dhe mjekve për të më marrë parasyshë dhembjet e padurueshme …Por ata, në vend që të kujdeseshin sipas profesionit të tyre human, më provokonin duke më nxituar që, me fajin tim, të lëshoja klinikën dhe të mbetesha në mëshirën e dhimbjeve. Dhe më në fund, ata më nxorën nga klinika pa më dhënë kurfarë përmirësime të gjendjës sime shëndetësore. Pas 4 ditësh nga dalja nga klinika, në banesën time më vazhduan dhembjet e padurueshme duke u rritur me krizë edhe më të madhe, duke u përhapur në krahun e majtë dhe në shpatullë, nën sqetull, në anën e majtë të fytyrës si dhe në anën e majtë të boshtit kurrizor duke shkuar deri në tru. Pastaj mu keqësua edhe frymarrja. Mu skuqën veshi i majtë, qafa në anën e majtë, si dhe të gjitha pjesët e trupit nga ana e majtë gjithashtu. Familja ime, e shqetësuar nga kjo gjendje shumë delikate e shëndetit tim, thirri ndihmën e shpejtë…. Aty, duke më parë të tillë, më dhanë ushqim artificial-infuzion dhe pastaj Morphine. Neurologu deklaroi se është i panjohtuar për këto simptome dhe kërkon ndihmë e shefit neurologjik për sëmundjën algoneurodystrophie. Pas shumë orvë pritje, më në fund arriti neurologu, i cili pas ekzaminimit, konsaton se gjendja ime ishtë tejet e komplikuar dhe nuk ka mundësi të më ndihmojë. Ai më sygjeroi që të shkoj në banesë duke më premtuar se, në konsultim me kolegët e vet, do të bëj të mundshme një egzaminim më të përsosur. Por kjo nuk ndodhi dhe as që ka ndodhur deri më sot.

Fillimisht dyshova derisa u binda plotësisht se të gjitha këto injorime dhe keqtrajtime medicinale kanë qenë të ndikuara nga mjekët e Sigurimit Shëndetësor, SUVA. Mjekët e dinin mirë shkakun e gabimit profesional mjekësor dhe detyrimit edhe dëmin moral dhe material që më detyrohen ligjërisht. Por bashkëpunimi i tyre jo në favor të shëndetit tim por te rrënimit të mëtejshëm të tij tregon se asnjëri prej tyre nuk dëshironte shërimin tim. Madje ata janë të interesuar që të më paraqesin edhe si të sëmurë psiqik, mjaft që të mbulonin fajin e tyre duke e pasur nesër më të lehtë para gjykatës pasi fjalët e një të sëmuri psiqik nuk merren në konsideratë. Por unë posedoj deklarata të hartuar nga mjekë të tjerë të cilët vërtetojnë pretendimin tim, pra atë se ndaj meje është bërë një ndërhyrje e pafalshme kirurgjikale e cila më ka lënë pasoja të pariparueshme.

**A jeni vizituar jashtë Zvicrës?**

Duke mos humbur shpresat për një trajtim human e mjekësor dhe duke hulumtuar edhe nëpërmes internetit, vendosa që të shkoj për një kontrollim rutinor në një poliklinikë e specializuar për duar – d.m.th. te një specialist i njohur në Belgjikë, konkretisht te Dr. Huard në klinikën "Parc service electromyographie". Kjo u realizua më 26 gusht 2005. Pasi kontaktova, me anë të telefonit, mjeku belg më caktoj një takimin të shpejtë, për çka edhe i jam shumë mirënjohës. Ai më dëgjonte me shumë vëmendje për të gjitha peripecitë e mia dhe pas shikimit të dokumenteve mjeksore që ia tregova si dhe pas kontrollimit shumë të kujdesshëm më pyeti i habitur: "-Kush është ai mjek që të ka thënë se duhej t'i nënshtroheshe një operacionit të tillë?!

Dhe pasi më sqaroj se "ky hap i mjekëve zviceran ishte shumë i gabuar, dhe si pasojë, sëmurja jote nuk vjen vetëm nga "algoneurodystrophie", por nga ky operim i gabuar duke të dhënë se gabimisht anestazionin post-opèratoire, dhe diagnoza e saktë quhet "plexus brachial". Në vend që të përdornin likidin për të pirë dorën ata përdoron një likid që quhet Klorur Postazium Toksik. Kështu tu dëmtuan 10 nerva. Por nëse ky gabim do të bëhej me gjilpërë nuk do të ishin lënduar më shumë se një apo 2 nerva e jo tëre zona e plexus brachial. Vetum një toksike mund ta bënte një lëndim të tërë.", konfirmoi mjeku belg Huard. Këtë e dëshmojnë më së miri EMG dhe 2 fotografi mjekësore, përkatësisht njëra e bërë në Bruksel e tjetra në Kosovë. Njëkosisht kjo vërtetohet edhe nga një ekspertizë juridike e pavarur që kemi bërë në Gjenevë etj. Kjo është një sëmundje e përjetshme dhe e pashëruheshme sipas të gjithë mjekëve që më kanë vizituar më pas. Këtë diagnozë e vërtetojnë të gjithë vizitat që bëra pas atij operacioni fatal në klinikën "La Source". Nga nevoja për një shërim adekuat kam shkuar te shumë specialistë, si në Kosovë, Austri e Gjermani gjithe ashtu nè France, ku më kanë thënë se diagnoztifikimi i mjekut nga Belgjika ishtë i saktë, kuptohet edhe pas një egzaminimit të tyre. Me fjalë të tjera janë tèrë nervat e mia të lënduara ne teritorin plexus brachial, dhe gjithashtu një infektim .

Këtë gabim të pafalshëm gjatë operimit tim si dhe kushtet në të cilat unë u operova pa praninë e mjekut anestezist e ka konstatuar dhe dokumentuar edhe Dr. Anne -Marie Bendahan në Strasbourg e cila është në të njëjtën kohë edhe Sekretare e Shoqatës Kombëtare të Mjekëve të Këshillit të Rekursit në Francë. Zonja Bendahan u prek dhe në të njëjtën kohë u revoltua shumë kur pas vizitës që më bëri mësoi gafat e pafalshme profesionale të Dr. Stuzeneggerit. Deklaratat e lëshuara prej saj ju i keni në dispozicion. Kjo zonjë e nderuar më është shprehur e gatshme që të dëshmojë profesionalisht para cdo gjykate, si në Zvicër ashtu edhe në Gjykatën Europiane në Strasbourg për cështjet që kam hapur kundër klinikës "La Source" dhe Dr. Stuzenneger që më shkatërruan jetën. Po kështu edhe mjaft mjekë të tjerë belgë, austriakë, kosovarë dhe madje edhe zviceranë, pasi më kanë vizituar janë në të njëjtën linjë profesionale dhe janë edhe ata të gatshëm që të dëshmojnë...

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë jeta ime është shkatërruar. Kjo vjen nga injorimi, mungesa e humanizmit dhe e vullnetit të mirë nga ana e disa mjekëve në Zvicër si Dr. Stuzengger dhe ekipi i tij. Edhe më pas ky i fundit u tregua mjaft arrogant. Unë habitem se si monstra të tilla kanë bërë Betimin e Hipokratit. Ata preferojnë që të mbeten solidarë në paaftësinë dhe pandershmërinë e tyre në vend që të tregojnin të vertetën dhe të bënin përpjekje për të më shëruar atëherë kur kjo mundësi ekzistonte. Përballë kësaj padrejtësie unë gjendem i dënuar që të mbetem hendikap përjetë. Është kjo arsyeja për të cilën ngjarja ime më ka obliguar që t'ju lutem juve për ta publikuar në mënyrë që padrejtësi të tilla të mos të përseritet më kurrë.

**Gjatë bisedës jeni shprehur për presionet, incidentet e deri në atentatet fizike që janë kryer ndaj jush dhe pjestarëve të familjes suaj me qëllim që t'ju detyrojnë që të heshtni për këtë skandal. Lutem të ndaleni konkretisht në rastet që ka qenë më të rëndë dhe flagrant.**

Po, është e vërtetë. Një atentat i rëndë më ka ndodhur në korrik të vitit 2006 kur isha në Kosovë. Po pija një kafe më një mik timin në një lokal të Prishtinës dhe shoh të na afrohet një person që fliste frëngjisht dhe që po tentonte të më fotografonte. I thashë që të largohej se nuk doja që të fotografohesha nga një i panjohur por ai vijonte të më shikonte dhe kjo më bëri të dyshoj. Pas pak minutash hipëm në makinë dhe duke u kthyer jashtë Prishtinës, në afërsi të një tuneli, një person na kishte dalë para në anën e majtë, ne mesin e hyrjes së tunelit. Ai shkrepi nje plumb me snajper në drejtimin tim. Shpëtova për mrekulli sepse kisha ngadalësuar instiktivisht paksa shpejtësinë kur pashë këtë skenë








Dr Christophe Rapin
Pl. de la Gare 9A
1003 Lausanne
021/311 47 51

A qui de droit

Lausanne, le 10 février 09

**Monsieur Ismajl Qerimi – né le 11.07.1975.**

Le médecin soussigné atteste que suite à l'injection d'un produit non adapté pendant une opération le 22.09.2004. L'anesthésiste n'était pas présent et c'est un auxiliaire qui a officié.

Depuis ce patient souffre de violentes douleurs au niveau du plexus brachial, douleurs nécessitant la prise de dérivé morphinique interdisant tout travail.

Le patient demande que l'erreur médicale soit reconnue et qu'il perçoive un dédommagement.

Ces lésions sont irréversibles et aucune amélioration n'est à attendre dans le futur.
Ces lésions sont à vie.

Dr Christophe Rapin

dhe pashë flakërimin e plumbit pak metra para automjetit. Atë ditë më ka shpëtuar Zoti. Qysh atë ditë e kuptova përfundimisht se duan të më eleminojnë fizikisht në pamundësi për të më mbyllur gojën për të drejtat e mia lejitime të përdhunuara në mënyrë flagrante nga shteti zviceran. Miku im ishte prezent dhe mund të dëshmojë për këtë atentat që për pak më kushtoi jetën. Gruaja u trondit shumë dhe gjatë një kontrolli të imët që i bëri automjetit tonë për siguri, gjeti një aparat të vogël përgjues. Vëllai e ruajti këtë për të bërë denoncimin dhe për momentin më largoi larg nga shtëpia për arsye sigurie.

het… Kur u ktheva në shtëpi përjetova një tronditje akoma edhe më të madhe. Gruaja ishte zverdhur dhe shokuar nga incidenti pasi kishte parë cdo gjë në momentin kur doli nga shtëpia. Në këto kushte depresive ajo humbi fëmijën tim të dytë sepse ishte shtatzënë…

Vetëm pas pak kohësh mësova nga burime të mirëinformuara se lituanezi që kapëm dhe denoncuam kishte dy të afërm nga rrethi i tij familjar që punonin në klinikën La Source. Pra dyshimet dhe akuza që bëra bashkë me vëllain qenë të bazuara dhe të sakta sepse unë nuk kisha të bëja me atë njeri. Në këto kushte e denoncova edhe këtë fakt por përgjigja bela i shkroi një letër prej 2 faqesh Këshillit Federal të Zvicrës duke i përmbledhur kalvarin e vujatjeve të mia dhe të familjes. "Stop eksperimenteve humane" , "…C'farë do të bënit ju po të ishit në vendin tonë?", janë disa nga pyetjet qe ajo i drejtohet këtij institucioni…. Për pak kohe na lanë të qetë por provokimet nga më vulgaret edhe nga ana e policisë dhe civilëve të veshur me pushtet vijuan edhe më vonë…

Në këto kushte flagrante diskriminimi dhe represioni ju iu drejtuat gjykatës dhe prokurosisë. C'farë padish dhe kundër kujt i keni ngritur konkretisht?

një klinike private apo shtetërore (!!).Ky fakt ndodhet në fq 11 të dokumentit konfidencial që jua kam vë në dispozicion. E gjeni në fq. 11. Por atë nuk e detyroi askush që ta merrte rastin tim. Ndërkohë me avokatin e tretë fillova procedurën penale dhe civile por edhe ky u tërhoq pas presioneve që i erdhën nga funksionarë të kantonit të Vaudit pasi kishte përfituar edhe ky mjaft pagesa për shërbimin e tij të pakryer ndaj meje. Në rastin më të mirë avokatët zviceranë i shoh të pafuqishëm për cështjen time. Ky është realiteti në Zvicër.

A keni ende shprese te drejtesia per shkel- kantoni i Vaudit, gjykata e të cilit ma bllokoi dhe sabotoi cështjen time deri duke tentuar që të më zhdukte dosjen.

Ka ndërhyrë me një letër pranë Ambasadës së Zvicrës në Prishtinë për problemin tim edhe Ministri i Jashtëm i Kosovës Enver Hoxhaj. Këtë letër e kam dorëzuar unë së bashku me Këshilltarin e z. Hoxhaj. Asnjë përgjigje. Së fundi i kam shkruar për dramën që po për rjetoj në shkurt të këtij viti edhe Ministrit të Jashtëm të Zvicrës. Përsëri heshtje…

Në rast se cështja ime do të vazhdojë të zvarritet atëherë unë do të dal publikisht së









Jam sulmuar edhe pranë banesës sime natën e 22 shkurtit 2009 nga 5 persona të maskuar dhe të armatosur. Dhe ky atentat erdhi gjatë periudhës kur unë komunikoja me gazetarin Fabio Bonavita të "Lausanne Cites" në lidhje operacionin e gabuar gjatë operimit tim në klinikën "Source". Me fjalë të tjera unë kam qenë dhe me siguri që vijoj të jem i survejuar në lëvizjet e mia. Po kthehesha në shtëpi dhe pashë 5 persona në 2 automjete. Ata kishin parkuar njërën makinë në vendparkimin tim dhe tjetrën në anë të rrugës. Kur e pashë këtë skenë nga makina ime kam tentuar që të kthehem me shpejtësi nga rruga kryesore, bërtita dhe i telefonova vëllait tim që banon aty pranë. Gruaja ime që ndodhej në shtëpi dëgjoi thirrjet e mia dhe doli të dera. 4 prej tyre u larguan menjëherë sepse më panë kur telefonova nga makina. Njëri prej tyre deshi të më qëllonte por në atë moment kaloi një makinë dhe dritat e dejtuara nga ne e frikësuan agresorin duke kujtuar se mbase ishte policia. Kjo rastësi më shpëtoi. Ndërkohë unë arrita që të bllokoja njërin prej tyre me ndihmën edhe të vëllait që mbërriti menjëherë. E mbërthyem në flagrancë sepse nuk kishte mundë si manovrimi në një rrugicë qorre dhe i morëm kartën e identitetit për ta denoncuar në polici, së bashku me një foto që ia bëmë po aty me celular. Ishte nga Lituania. Në stacionin e policisë në Renens na pyetën se nga kush dyshonim se më vjen ky agresion. Ia bëmë të qartë se qysh nga dita e operimit tim fatal, shumë incidente kanë ndodhur me mua dhe për këtë bëj fajtor punonjësit e paguar të SUVA dhe klinikën "La Source". Policët u treguan indiferentë duke më thënë se kjo akuzë nuk ka se si provo-

ishte mëse qesharake; Sipas policisë lituanezi që bënte pjesë në grupin që më sulmuan para shtëpisë nuk jetonte më në Zvicër (!!!). Në fakt kam informacione të sakta se ai jeton edhe sot në zvicren gjermane. U demoralizova edhe më tepër pasi mësova se tashmë aleatë me bluzat e bardha të klinikës Source dhe SUVA-s ishte bërë edhe policia. Pajtuam një dedektiv privat dhe ai arriti që të mbërthente dhe të shtrëngonte mercenarin ordiner nga Lituania që të pohonte të vërtetën në lidhje me agresionin kundër meje. Po kë shtu, një dedektivi privat që pajtuam me pagesë na bë ri të ditur se lituanezi kishte lidhje me klinikën "La Source pak kohë pas denoncimit që i bë ra pë r agresionin e tij të provuar. Bashkangjitur keni deklarat n e lituanezit ku ai pohon se është paguar me 5 mijë franga zvicerane për të hyrë në shtëpinë time dhe për të zhdukur cdo dokument komprementues të dosjes sime . Përse do të ishte i interesuar për zdukjen dosjen time litonezi i panjohur dhe mbase ende pa dokumenta të rregullta në Zvicë r? Pra ka qenë klinika "La Source" që e ka ushtur nga pas pë r të mos dalë vetë në skenë . Gjykata e Kantonit të Vaudit vendosi pushimin e cështjes për mungesë provash sepse askujt nuke i interesonte e vë rteta. Fillova të dyshoja sepse Kantoni i Vaudit duke mose deshirrur nje imazhe te keqe para bote dhe nje skandal të tëre deshiruan përseri heshtje(!!) megjithëse ne e denoncuam në flagrancë agresorin pasi e detyruam që të na jepte identitetin. Ju përmenda vetëm 2 nga sulmet dhe atentatet më të rënda që kanë organizuar kundër meje por ka edhe të tjerë gjatë këtyre viteve…

Pak muaj pas këtij sulmi, gruaja ime Isa-

Unë kam hapur gjyq kundër SUVA (Sigurimi Shëndetësor i Aksidenteve në Punë ), kundër kirurgut Michael Stuzengger, kundër Klinikes "La Source" si dhe kundër infermieres Sabine Noel e cila u fut në mënyrë joligjore në sallën e operacionit duke zëvendësuar mjekun anestezist si shkaktarë të përkeqësimit të mëtejshëm të gjëndjes sime shëndetësore. Për mua ka një cështje sociale për pensionin prej 9 vjetësh, një procedurë penale që prej 3 vjetësh dhe një procedurë civile. Në të trija rastet ka vetëm zvarritje të qëllimshme për të mos ardhur në vendimin i cili dukshëm që është në favorin tim. Të gjithë këshilltarët e shtetit në Ministrinë e Shëndetësisë janë të mirëinformuar me dosjen dhe vuajtjet e mia por ata preferojnë që të heshtin. Vetëm para pak kohësh më kanë zhdukur një pjesë të rëndësishme të dosjes sime civile në Gjykatën e Kantonit të Vaudit duke arritur që t'i thonë me pafytyrësinë më të madhe gruas sime se dosja ime nuk ka ekzistuar kurrë. Por unë posedoj të gjithë dokumentet origjinale duke qenë i vetëdijshëm më përpara për këto manovra të ulëta nga ana e tyre.

**Po qendrimi i avokateve tuaj cili ka qene dhe eshte aktualisht?**

Avokat Guigax nuk ishte në gjëndje që të përballonte presionin psikologjik të sistemit të Kantonit të Vaudit dhe e braktisi cështjen time. Avokat Poggia më ka dhënë vetëm premtime por deri tai asgjë. Madje edhe pas pagesave që ai ka marrë nuk po shoh ndonjë inisiativë të tij në celjen e gjyqit. I pyetur për cështjen time ai ka deklaruar se nuk do të mbronte viktimën në një cështje kundër jet qe ju janë bërë ? Si do te operoni konkretisht ndaj këtyre padrejtësive që ju kanë bërë dhe që po i vuani ende?

Unë shpresoj gjithmonë se drejtësia do të fitojë por jo në Zvicër. Tani cështja ime ndodhet në Gjykatën Europiane të Strasburgut për zvarritje që Gjykata e Kantonit të Vaudit i ka bërë qëllimisht cështjes sime. Unë do ta vazhdoj luftën time deri në fund në bazë të dosjes së plotë të provave të pakontestueshme që i kam paraqitur atje. Dua t'i tregoj kë saj Gjykate të nderuar dhe Këshillit të Europës se Kosova u kritikua ashpër pë r zvarritje të cështjeve gjyqësore deri në 5 vjet në një kohë që cështja ime po zvarritet prej 9 vjetësh në një shtet si Zvicra. Gjykata e Kantonit të Vaudit, jo vetëm që nuk ka marrë asnjë vendim për denoncimet e mia flagrante por përkundrazi ka tentuar që të më demoralizojë dhe demotivojë duke i zvarritur cështjet. Në këtë mënyrë ata kanë kalkuluar sic duket se e vetmja mënyrë që cështja Qerimi të sabotohet për në Gjykatë e Strasburgut është bllokimi i procedurës qysh në Gjykatën e Kantonit. Pra një shkallë më poshtë se Gjykata Federale e shtetit helvetik e cila as që e njeh ende dosjen në fjalë. Sepse bluzat e bardha, policia dhe togat e zeza të kantonit të Vaudit janë të implikuara në këtë aferë. Ata kanë prerë hallkë n e ankimit tim duke ia fshehur këtë edhe pushtetit federal të Zvicrës. Unë i bëj apel Federatës së Zvicrës që të reagojë ligjërisht ndaj këtyre presioneve që po vijojnë të më bëhen mua dhe familjes sime, vetëm e vetëm se po ngre zërin për të drejtat e mia të mohuara. Kjo sepse në rast se Gjykata Federale do të merrej seriozisht me këtë cështje, të gjithë fajet do t'i merrte bashku me familjen në një grevë të pakthyeshme urie përpara një prej institucioneve kryesore të shtetit zviceran. Le të shërbejë vetësakrifikimi im me qëllim që kjo fatkeqësi që më ndodhi mua të mos u ndodhë emigrantëve të tjerë në Zvicër. Durimi im ka marrë fund dhe kjo që ju thashë do të ndodhë shumë shpejt nëse autoritetet përgjegjëse në këtë vend do të bëjnë të paditurin. Në një shtet demokratik është detyrë parësore mbrojtja e shëndetit dhe e jetës së shtetasve të tij.

**Në mbyllje a keni ndonjë mesazh për të dhënë?**

I lutem publikisht Kryeministrit të Kosovës dhe qeverise së Shqipërisë që ta ngrenë zërin më shumë për të drejtat e mohuara të shqiptarëve në mërgim duke caktuar me ligj për këtë temë një hapësirë të caktuar në televizionet respektive shtetërore. Por në vecanti, lutja ime shkon për Kryeministrin e Shqipërisë që të më ndihmojë duke ushtruar autoritetin e tij shtetëror dhe politik për këto që po heq prej 10 vjetësh në Zvicër me qëllim që drejtësia të vihet në vend. Për mua e rëndësishme është që të ndërhyjë autoriteti I shtetit shqiptar e jo cili individ që është në krye të tij sepse këtë të fundit e vendos sovrani me votë. Zëri i shtetit shqiptar ka më shumë peshë në arenën ndërkombëtare në krahasim me Kosovën sepse Shqipëria sapo mbushi 100-vjet shtetformim dhe është vend anëtar i NATO-s. Familja ime, djali im 8-vjecar kanë plotësisht të drejtë që të jetojnë në paqe dhe në harmoni si dhe me dinjitet pas afro 10 vitesh frike, ankthi dhe pasigurie për të nesërmen.

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Berisha - rënia e një modeli. Nuk iku, e hoqën!

Pothuaj pesë vjet më parë, në gusht 2008, Sali Berisha suprizoi me një veprim që zakonisht e bëjnë të dashuruarit. Në majën e malit të Dajtit ai fshehu në shishe një mesazh, që pretendoi se do të hapej vetëm në vitin 2020. Të dashuruarit, premtimet e dashurisë i hedhin në det. Berisha, asokohe dhe gjithë kohën tjetër është dashnor i madh e pasionant i pushtetit dhe mesazhin e tij e mbylli në mal. Pothuaj pesë vjet më pas, të dielën e zgjedhjeve, megjithatë, ai kuptoi se dëshmitarët e tij të 23 viteve, i dhanë divorcin me pushtetin. Tre ditët që pasuan ai heshti dhe të mërkurën, pranoi dhe vetë një gjë të tillë e tha të vetmen fjali që nuk e kishte thënë kurrë në jetën e tij: Po iki! Dhe ktheu krahët përballë një turme pasionante që i përpinte fjalët dhe dëneste. Ndoshta më shumë se për ikjen e pabesueshme të tijën, dëneste për veten. Çdo humbje është në proporcion me pritshmërinë personale: Berisha humbi pushtetin real dhe u duk se dënesi, dikush humbi portofolin e ministrit, mandatin e deputetit, por ata nuk ndodheshin në turmë që t'u dallohej dënesja, shumëkush tjetër kuptoi humbjen e skuadrës për të cilën bënte tifozllëk, pavarësisht se ishte po aq i varfër, po aq i dërmuar sa tifozi i skuadrës tjetër fituese që festonte pikërisht atë për të cilën pala tjetër qante.

**Një epilog befasues**

Një politikan, në ballafaqimin e tij me të nesërmen, më së shumti mbahet mend për epilogun e karrierës së tij direkte politike sesa për vetë karrierën e tij. Në epilogun e tij Berisha mund të mburret se la pas dhe iku me zgjedhje që ishin absolutisht më të mirat në gjithë atë set zgjedhjesh alla shqiptare. Edhe pse gjatë fushatës e përpara saj përdori gjithçka kishte mundësi e në dorë, që nga administrata dhe strukturat e shtetit, nga policia, tek fëmijët e deri tek hipokrizia, gënjeshtrat e lumi i parave, ai i rezistoi tundimit që të ndërhynte në pikën thelbësore të zgjedhjeve: numërimin e votave. I rezistoi dhe tundimit se do të vazhdonte të ishte qëndrestar dhe se do të "ngrinte buzëqeshjen e fituesit", siç kishte premtuar të bënte dhe bëri në 2001-shin. Në të kundërt, pranoi rezultatin dhe me një gjest të jashtëzakonshëm politik që i fliste më së shumti të nesërmes, morri mbi vete gjithë përgjegjësinë për disfatën elektorale. Duke shfajësuar kështu gjithë të tjerët në parti, duke ju hequr atyre sikletet e pafundme të debateve e rivaliteteve të llojit, çfarë bëra unë e çfarë bëre ti dhe duke hapur në këtë mënyrë, skenaret e PD-së së nesërme. Një proces që hyri në tranzicion disa mujor dhe që në fillim të vjeshtës do të afrojë rezultatin e tij, por që padyshim dhe jashtë çdo dyshimi, në thelb do të ketë emrin, fytyrën dhe vulën personale të vetë Berishës, pavarësisht formës që do të zgjidhet. Tashmë ai ka kuptuar nevojën e rithemelimit të PD-së. Mbasi mblodhi gjithkënd që kishte përzënë në vite, mbasi më së fundi të gjithë e pranuan si "destin" që kjo parti është pronë private e atij vetë, Berisha paralajmëroi transferimin e tapisë së saj. Në dukje e ka bërë zgjedhjen. Ai është Lulzim Basha, kryetar i Bashkisë së Tiranës, i vetmi që ka konkuruar dy vjet më parë me drejtuesin e opozitës që tani dy vjet më pas i mundi të gjithë. Ka një pafundësi arsyesh që e çojnë Berishën drejt një zgjedhjeje të tillë, ashtu siç ka dhe një mori arsyesh që pikërisht kjo kandidaturë e mundshme dhe krijesë e tij politike, mund të rrëzohet. Luajaliteti i tij me Berishën e sidomos problemet e mbartura nga e shkuara që nisin që me rrugën Durrës-Kukës e deri tek e Premtja e Zezë e 21 Janarit, mund edhe të kthehen kundër tij. E sigurt është që e nesërmja e PD-së do të reflektojë ekuilibret e rinj, brenda drejtuesve trandicionalë të saj si Topalli, Olldashi, Bode e Patozi, Imami, Ruli e të tjerë, por në proporcion me atë sesa do të dojë vetë Berisha të krijohen këto ekuilibra.

**Vota për demokracinë**

Sali Berisha është padyshim personazhi më kontravers i Shqipërisë pluraliste dhe me siguri do të jetë i fundmi i trinomit të ndryshëm/të ngjashëm me paraardhësit e tij, Zogu e Hoxha. Ahmet Zogun





e urrente në rininë e tij komuniste, e përbuzte gjatë rinisë së tij politike dhe e dashuroi me pasion në pjesën e fundit të karrierës së tij të vrullshme. Enver Hoxhën e idhujtarizonte në rininë e tij komuniste, e urreu egërsisht në rininë e tij politike dhe e imitoi dukshëm në pjesën e fundit të karrierës së tij.

Ai ishte edhe njëri, edhe tjetri.

Ai ishte herë njëri dhe herë tjetri.

Sali Berisha bashkohej me Zogun dhe Hoxhën në arrogancën me të cilën ushtronte pushtetin dhe diferencohej nga bashkëpunëtorët, bashkohej në mënyrën sesi personalizoi politikën dhe ndërtoi e lejoi bashkëpunëtorët t'i ngrejnë kultin e frikshëm të individit, ngjante me ta në mënyrën sesi trajtoi miqtë e armiqtë dhe ishte identik me ta në shkëputjen totale nga realiteti. Ndryshon nga ta vetëm në kontekst kohor dhe modelet e kostumeve që vesh, ndryshon në formë, por jo në thelb me ta, njëlloj ballkanas e dinak, njëlloj i gatshëm të shenjtërojë çdo mjet për hir të qëllimit për pushtet dhe pushtetit si qëllim në vetvete.

Sali Berisha është qënie e mirëpolitikës shqiptare. Autoritarist dhe pragmatist, ai gaboi vetëm në një pikë të verifikuar dhe nga eksperienca e varfër politike në vend: pushteti bie nga pesha e tij.

Më shumë se kaq, Berisha ra sepse ju kundërvu sistemit dhe u shndërrua në një rrezik serioz për vetë demokracinë që në thelb parasheh balancën dhe kontrollin mes pushteteve. Pikërisht këtu e sulmoi instikti i pagabueshëm i shqiptarëve: në 23 qershor, në thelb, ata nuk votuan as Edi Ramën, as Ilir Metën e gjithë koalicionin e majtë, ata nuk votuan as vetëm kundër partisë së tij, por votuan për demokracinë. Ky lexim i ndryshëm i natyrës së votës së shqiptarëve, ka gjasa të jetë i vërtetë nëse krahasohet thelbi i dy sistemeve që zëvendësuan njëri-tjetrin njëzet e ca vjet më parë: njëlloj si në komunizëm, në vend të demokracisë reale, u tregtua partitokracia si demokraci. Ka pluralizëm, por vendos për çdo gjë e gjithçka vetëm një parti, ka liri tregu, por liria është e kontrolluar dhe pilotuar vetëm për klientë korrektë politikisht, ka liri fjale, por dhe liri për të mos dëgjuar vetes me emër dhe mbiemër njëlloj si personazhet e Big Brother-it dhe të lejonte të tjerët ta quanin prijësi ynë. Ra sepse duke qenë në këmbë nuk mund të afronte më asgjë tjetër për një vend të zhytur më shumë se në krizë ekonomike, në një spirale krize ekzistenciale. Ra sepse nuk i frymëzonte më asgjë shoqërisë shqiptare.

## E mbani mend Enverin?

Edhe nëse ndërtohej një shkollë, një qendër shëndetësore, një hidrocentral apo qoftë dhe jepej një e drejtë studimi, formula ishte e qartë: ajo ishte dhuratë e partisë dhe e udhëheqësit. Ngjante se partia e komunistëve të djeshëm që pretendonte se ndërtonte një vend pa taksa për qytetarët, kishte një xhep magjik nga nxirrte paratë me të cilat paguhej zhvillimi i vendit dhe gjithë jeta e tij. Në fakt e gjitha kishte të bënte me rolin rregullator që shteti komunist përdorte në shpërndarjen e të ardhurave që prodhonin vetë qytetarët. Nuk paguhej për arsimimin dhe spitalet, por paratë dilnin po nga xhepat e përbashkëta të tyre, infrastrukturë ujore më moderne që ekziston.

Shqipëria – vend i zhvilluar, për ne ishte dhe është para së gjithash Shqipëria e dijes. Për të arritur këtë objektiv ne mbi dyfishuam rrogat e mësuesve, ndërtuam dhe rindërtuam mbi 1300 shkolla fillore, nëntëvjeçare, të mesme, korpuse universitare. Ne sot, njëlloj si vendet e zhvilluara, kemi shtrirë internetin në çdo shkollë, nga vetëm 45 shkolla që kishin internet dhe nga vetëm 700 kompjuter që ishin shkollat tona pak vjet më parë, sot kanë mbi 24.500. Shqipëria ka arritur nivelin e vendeve të zhvilluara për studentë për 1000 banorë dhe përqindjen e nxënësve që ndjekin shkollat e mesme".

Marrëzi apo një gënjeshtër e përsëritur e shtuar me pretendimin se PD e futi Shqipërinë në NATO dhe hoqi vizat për udhëtimin në vendet e BE-së? Është qeveria ajo që ndërton rrugë apo qeveria duhet të ndërtojë politika? E shpiku qeveria internetin e Facebook-un që e referon shpesh, apo ato janë zhvillime normale teknologjike? Ishte Shqipëria që hyri në NATO apo njëlloj siç do të bënte Enveri, ka vetëm heshtje për pyetjen: si janë ndërtuar, a janë ndërtuar realisht ato që duheshin ndërtuar dhe a do të duhej të ndërtoheshin më mirë? Keqkuptimi i madh komunist që e sheh qeverinë si një lloj kryetari komune që ndërton ujësjellësa dhe kanalizime u mbart po nga vetë botëkuptimi komunist i vetë Berishës. U mbart deri në pikën që ai me siguri e beson edhe vetë se gjithçka në këtë vend që është frut i zhvillimit normal të vendit, është garantuar prej atij vetë. Nga kjo pikpamje, shqiptarët i thanë "Jo!" edhe politikëbërjes sipas stilit të Babo Natale-s me thes në dorë që diku hedh një rrugë rurale, diku një qendër interneti e diku tjetër një ujësjellës apo një urë.

## Basti për historinë

Ky është padyshim basti i madh i Sali Berishës. Një njeri që ka ditur të ngjallë dashuri dhe urrejtje si pakkush në këtë vend. Gjithmonë do të ketë shqiptarë që do ta duan marrëzisht dhe shqiptarë që do ta urrejnë me të njëjtin pasion. Për të



filltë politike, me shumë dritëhije, me shumë më shumë hije sesa dritë, ai njeri është kasaforta e mbyllur e gjithë paqartësive, anktheve e dilemave që kanë shoqëruar rrugëtimin e vendit në pluralizëm. Duke nisur që me dhjetorin e 90-ës, rolit të tij në atë kapërcyell kohor, faktit sesi u përfshi, kush e përfshiu dhe si monopolizoi një lëvizje që nuk ishte e tij.

Ai qëndron pas gjithçkaje të mirë dhe të ligë, që ka ndodhur në Shqipëri; i aftë të personalizonte gjithçka në anën e tij politike, por shumë shpesh kushtëzues i anës tjetër të gardhit politik, i gatshëm për piruete që do t'i merrnin mendjen çdo balerine, por që e ktheu baletin politik në ringun e vetëm të kundërshtarin dhe zërat ndryshe. Diskriminimi i shqiptarëve sipas përkatësisë politike u bë mbizotërues dhe kjo ishte e fundit gjë që votuesi do të falte. Ndaj e ndëshkoi me votë regjimin hibrid të ndërtuar. Më shumë se për të sotmen e dy mandateve rresht të demokratëve, shqiptarët refuzuan modelin e frikshëm të mandatit të tretë. Sepse nëse Shqipëria do të ishte vetëm disa qindra kilometra më tutje në Lindje, ajo nuk do të kishte asnjë ndryshim nga ish-republikat sovjetike që bëjnë rregullisht zgjedhje, por që para tyre dihet mirë se kush do të zgjidhet. Berisha ra sepse ishte koha që ai të binte. Madje ra vonë! Ra atëherë kur Sali Berisha e kishte bërë të udhës t'i drejtohej paguanin qera minimale për banesat apo energjinë, por paratë vinin sërish nga puna e papaguar e tyre. Ishte përsëritur aq shpesh kjo lloj gënjeshtre groteske sa ishte kthyer në bindje popullore atëherë dhe në kartë politike sot kur përdoret e njëjta teknologji. Çfarë thotë vetë Berisha në fjalimin e tij të fundit? "Ne duhet të jemi krenarë sot me Partinë Demokratike, sepse për të bërë të vërtetë ëndrrën e Shqipërisë së zhvilluar të qytetarëve shqiptarë, ne ndërtuam në mbarë vendin qindra ujësjellës dhe sisteme kanalizimi, një seri sistemesh të pastrimit të ujërave të ndotura dhe natyrisht mbetet ende shumë punë për të bërë. Por, në mandatin tonë të ri ne do ta bëjmë Shqipërinë me ishte politika e zgjerimit të NATO-s që i siguroi vendit nën këtë sistem global sigurie? Ishte PD që hoqi rregjimin e vizave apo kjo është gjithashtu pjesë e politikës së hapjes së BE-së në vendet e Ballkanit? Natyrisht që vendi ka plotësuar kritere dhe kushte të caktuara, por kjo është thjesht dhe vetëm detyra e saj. Nuk mund të quhet arritje ajo çfarë është normale. Njëlloj si rritja e rrogave e pensioneve që është përgjigja për shtrenjtimin e nivelit të jetesës, por që nuk i jep përgjigje pyetjes: sa më shumë të mira materiale blejnë shqiptarët me këto rroga e pensione të shtuara në krahasim me vite më parë. Dhe kur vjen puna tek rrugët, sërish janë shkruar mijëra kilometra me letër dhe në 23 vjet ka qenë pjesë e bisedave të çdo shqiptari sepse ai ka ndikuar në jetën e çdo shqiptari. Për të do të vazhdohet të shkruhet edhe më tej dhe shumë madje. Por e vërteta për të nuk gjendet vetëm në Shqipëri. Pjesë të portretit të tij politik, të para dhe të pas viteve 90', janë të skicuara dhe gjetkë. Ndoshta duhet të kalojnë 25 apo 50 vjet kur të qëmtohen dhe pjesë të tjera të padukshme të puzzle-s të këtij personazhi të jashtëzakonshëm që në qershorin e vitit 2008 ka mbyllur një mesazh privat në shishe dhe që e ka fshehur diku në malin e Dajtit.

**Lorenc Vangjeli**

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Kështjella që ha libra

## *LIBRI NË KOHËN E KRIZËS*

***- NJERËZIT LEXOJNË GJITHNJË E MË PAK.***
***- DIKUR LEXUESIT RRININ NË RADHË PËR TË BLERËLIBRIN E RI TË AUTORËVE TË PREFERUAR. TANI RRINË AUTORËT NË RADHË NË KËRKIM TËLEXUESVE.***
***- MBYLLEN OSE RREZIKOJNË TË MBYLLEN LIBRARI QËKANË BËRË HISTORI NË PROPAGANDIMIN E SHITJEN E LIBRIT.***

Kohëte fundit kam ndeshur në disa fakte tronditëse për çdo dashamirës të kulturës eveçanërisht të librit, të cilat tregojnë se libri po humbet gjithnjë e më shumëterren në jetën e përditshme të njerëzve. Arsyet janë të shumta, e padyshim vendin e parë në këto arsye e zë kriza e rëndë ekonomike, që po ha në radhë tëparë librin. Në Sant' Arcangelo, një qytet i vogël por i bukur në afërsi tëRiminit, me një kështjellë të bukur mbi kodrinën që dominon qytetin, mësova njëfakt të hidhur. Kështjellës së parë, që rrezaton kulturë e histori, iështëvënë përballë një "kështjellë" tjetër prej betoni, një kapanon i madh melartësinë e një pallati 3 katësh, që flet për degradimin e kulturës. Në këtë"kështjellë" janë mbyllur mbi 100 milionë volume, libra të pashitur, që i kanësjellë këtu nga libraritë e Emilia Romanias. Një shifër marramendëse, po tëmendosh se këto libra i përkasin vetëm njërës nga 20 rajonet e Italisë.Destinazioni i këtyre librave: Të përfundojnë në karton. Deri tani janë dërguarpër karton 1 milion libra në vit. Por kjo sasi është shumë e pakët, dukemenduar sasinë që vazhdon te vijë e për kartonizimin e tyre do të duheshinnjëqind vjet me këtë ritëm. Kështuqë po kërkohen mundësi të reja për taboshatisur më me shpejtësi kështjellën që ha libra.

Midis radhëve me lartësi mbi 10 metra të librave, vërtitet herë pas herendonjë bukinist i pasionuar por edhe nevojtar, që vjen e zgjedh libra me vlerëtë veçantë, për t'i shitur pastaj nëpër bankarela për 1 euro. Me vlerën e 4-5 librave blen një panine, sa për tëmbushur barkun. M'u kujtua që verën e kaluar, kur pushonim në Alpe, në njëmercatino të gjërave të përdorur, gjeta edhe një vëllim me tri komedi tëMolierit në gjermanisht, shtypur në vitin 1947 në Austri. Çmimi : 50 cent,domethënë gjysmë euro. Nuk mund ta lija një botim të tillë, me një grafikë qëtë ftonte, pavarësisht se nuk di gjermanisht. (Për fat tani e ka dhënë vajzaprovim gjermanishten dhe e lexon ajo). Njerëzit në atë mercato ndaleshin edhepërpara gjërave më të kota, por, për fatin tim, askush para atij libri.

Një dizinteresim për librin që po çon edhenë mbylljen e shumë librarive. Kohët e fundit u mbyll një nga libraritëhistorike në Palermo të Siçilisë, që ishte kthyer gati në një tempull tëlibrit, libraria « Flaccovio ». E dyta në Sicili për nga rëndësia, ajo ka qenë një lokal i dashur kukalonin orë e orë shkrimtarë e artistë si Leonardo Sciascia, Moravia. Guttuso,Maraini e shumë të tjerë. Por, kriza e pamëshirshme nuk kursen as gjëratekselente. Pronarët e saj u detyruan ta mbyllin librarinë e famshme. Asnjëinteresim apo investim nga ana e enteve kulturale lokale e kombëtare. Dhe tëmendosh se në atë lokal hapet tani një dyqan për rroba intime. Të vjen tëthuash me vete se njerëzit në kohët e sotme mendojnë më shumë për prapanicën sepër kokën.

Nërrezik është vënë edhe ekzistenca e librarisë "Hoepli" në Milano. Kjo libraribështë hapur në vitin 1870 nga zviceraniUlrico Hoepli dhe ka mbi 140 vjet që është bërë pikë referimi për cilindo qëkërkon të gjejë një libër të rrallë, një manual apo hartë që nuk e gjen nëlibraritë e tjera. Me aktivitetin e vet, familja Hoepli në vite u bë njëdinasti. Në raftet e saj 175 mijë tituj e mbi 500 mijë volume. Pjesëtarët e sajpunonin këtu, mes rafteve e volumeve të kësaj librarie. Barbara, një ngapinjollët e fundit të dinastisë, deklaron: Libraria jonë ka patur sukses, sepsene nuk e kemi parë kurrë librin si një mjet comercial, për ne libri ka qenë embetet mision, ndaj është kthyer në pasion e traditë të familjes.

Përfat të mire pinjollët e kësaj dinastie, përballë krizës, kanë ditur tëpërshtaten dhe të bëhen krijues në punën e tyre. Duke ditur që tashmë ështëinterneti që i bën një konkurencë të pamëshirshme shitjes së librit (sepsemiliona libra shkarkohen falas nga rrjeti), pronarët e librarisë kanë vënë online shumë tituj e emri Hoepli bën që të pasionuarit e vërtetë të librit tëporositin aty ndonjë libër. Veç kësaj, ata kanë menduar që në ambientet shumëtërheqëse të librarisë të organizojnë çdo javë 1-2 promovime librash, duketërhequr kështu jo vetëm autorë, por edhe shumë lexues, të cilët pastaj kthehenedhe në blerës. Janë ide rinovuese që librarët e sotëm duhet t'i praktikojnëpër t'i bërë ballë krizës. E kisha parë këtë praktikë edhe në një librari tëvogël në Romë, ku një djalë i ri, i laureuar i papunë, kishte hapur një librariku bënte edhe promovime librash dhe aktiviteti i ecte mirë.

Mëka qëlluar jo rrallë që, duke lëvizur nëpër qytete të ndryshme të Italisë, mëkanë ndalur njerëz me libra në dorë, që t'i jepnin për çfardo oferte që t'ibëje. Në Verona e pyeta njërin: -E di autori që ju i shisni kështu librat etij? Dhe ai m'u përgjigj: - Po unë jam autori.

Fakt që flet vetvetiu më shumë se çdo koment.

Libri është në krizë. Nga njëra anë se ka një inflacion botimesh, sa nuki zënë as raftet e librarive e mbeten atje për vite me radhë derisa përfundojnënë "kështjellën që ha libra". Nga ana tjetër se ministritë e kulturës, apoentet kulturore, merren me çdo gjë tjetër, veç me librin jo. Ndaj u mbetetautorëve të merren vetë edhe me shpërndarjen, shitjen, apo në fund të fundit medhurimin miqve, veç që libri të mos përfundojë në karton.

Shumë lexues (edhe këtu padyshim kriza ka pjesën e vet) i shkarkojnëlibrat nga interneti. Unë per vete nuk heq dot dorë nga kënaqësia e marrjes sëlibrit në dorë dhe e shfletimit të tij. Se libri nuk është një objekt që të shërben për momentin, por është njëmik i dashur që të shoqëron tërë jetën. **Ndue Lazri**



# When love may turn to a real tragedy

